



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme
Detare Durrës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI PËRPUTHSHMËRINË
NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME DETARE DURRËS

DHJETOR 2021

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	7
II. HYRJA	9
1. Objekti i auditimit.....	9
2. Qëllimi i auditimit.....	9
3. Identifikimi i çështjes:.....	9
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:.....	9
5. Përgjegjësitë e audituesve:.....	10
6. Kriteret e vlerësimit.....	10
7. Standardet e auditimit.....	10
8. Metodot e auditimit.....	10
9. Dokumentimi i auditimit.....	11
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.....	12
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.....	12
2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.....	12
2.2 Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese, përputhshmëria ligjore e vendimeve.....	13
2.3 Mbi planifikimin, hartimin dhe realizimin e planit vjetor financiar dhe të biznesit si dhe raportimi i tyre.....	14
2.4 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.....	16
2.5 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi përputhshmërinë e kryerjes së shpenzimeve në lekë e valutë. Kryerja e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet e vogla (shpenzimet administrative për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, shpenzimet e marketingut, komisione e bonuse, penalitete, gjoba etj.).....	16
2.6 Mbi Zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave.....	20
2.7 Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të institucionit, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.....	23
2.8 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe auditit të brendshëm.....	28
2.9 Kontroll mbi administrimin dhe bazueshmërinë ligjore të administrimit të pronës.....	30
2.10 Mbi auditimin e krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore, bazuar në kuadrin rregullator ligjor.....	31
2.11 Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modelit nr. 8 ÷ Norma tekniko profesionale dhe metodologjia e shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 ÷ Për Arkivatö.....	32
2.12 Të tjera çështje që mund të dalin gjatë auditimit.....	33
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	36
V. ANEKSE	42

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Drejtoria e Përgjithshme Detare është institucion i financuar nga Buxheti i Shtetit dhe autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikën e zhvillimit të transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit për fushën e detarisë. DPD është institucion buxhetor publik, që ka personalitet juridik dhe ushtron detyrat e përgjegjësitë e saj në përputhje me Ligjin nr. 10109, datë 02.04.2009, òPër Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
1.	<p>Nga auditimi u konstatua se, DPD i ka kthyer përgjigje Kontrollit të Lartë të shtetit brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 09/2011, datë 23.05.2017. Me dt. 09.11.2017, KLSH ka audituar zbatimin e realizimit të rekomandimeve të lënë në auditimin e mëparshëm nga ku ka rezultuar se nga 21 masa organizative të rekomanduara, 1 është zbatuar, 3 nuk janë zbatuar dhe 17 masa janë në proces. Nga 2 masa për shpërbllim dëmi, janë zbatuar 2, dhe nga 4 masa disiplinore, janë zbatuar 4. Aktualisht, nga auditimi i realizimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, ka rezultuar se:</p> <p>A. Janë rekomanduar 21 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 12, 7 në proces zbatimi, 1 zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 rekomandim është kompetencë e Ministrisë.</p> <p>B. Janë rekomanduar 2 masa për shpërbllim dëmi në vlerën totale prej 290,089.8 lek, të cilat janë zbatuar.</p> <p>C. Janë rekomanduar 4 masa disiplinore dhe asnjë prej tyre nuk është zbatuar.</p>	12-14	E lartë	<p><i>Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masa që në të ardhmen të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të KLSH për përmirësimin e situatës brenda afateve të përcaktuara, raportimin sipas detyrimeve ligjore pranë KLSH si dhe marrjen e masave konkrete në rast të refuzimit të zbatimit të këtyre rekomandimeve nga ana e stafit të institucionit në konformitet me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.</i></p>
2.	<p>Pavarësisht se DPD Durrës ka plotësuar formularët duke respektuar tavanet limit të miratuar për vitet 2018 dhe 2019 në kërkesat për buxhet, projektbuxheti i dorëzuar në Ministri nuk është shoqëruar me një analizë të objektivave të DPD Durrës për vitin si dhe me produktet për realizimin e objektivave. Gjithashtu në kërkesat për buxhet, nuk rezultojnë të plotësuar formularë për kërkesat shtesë mbi tavanet limit të miratuar dhe argumentimin e domosdoshmërisë së këtyre fondeve, me qëllim alokimin e tyre nga Ministria e Financave sipas</p>	14-16	E lartë	<p><i>Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masa që gjatë hartimit të PBA-së, të plotësohen formularët për fondet jashtë tavaneve të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave referuar nevojave për investime, mallra e shërbime mbi këto tavane si kusht për mundësinë e çeljeve të fondeve për plotësimin e këtyre nevojave si dhe të merren masa për një planifikim e</i></p>

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	procedurave të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit dhe udhëzimet në zbatim të tij. Kjo ka bërë që DPD të mos ketë në dispozicion fondet e nevojshme sidomos për nevojat për investime.			<i>menaxhim të koordinuar të buxheteve vjetore me ato të PBA. PBA dhe raportet e monitorimit të shoqërohen me analiza të treguesve si dhe të objektivave e produkteve përkatëse.</i>
3.	Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme Detare, për vitin 2018 ka realizuar 14 procedura prokurimi me vlerë të vogël nga të cilat 4 procedura kanë objekte që i përkasin një grupi mallrash të ngjashëm. Konkretisht nga komisioni i blerjeve të vogla, janë copëzuar fondet për procedurat e prokurimit me objektet “Blerje dokumente specifik” me vlerë 797,900 lekë pa TVSH, “Blerje shtypshkrime” me vlerë 387,800 lekë pa TVSH, “Blerje kancelari” me vlerë 758,200 lekë pa TVSH dhe “Blerje tonerash” me vlerë 697,000 lekë pa TVSH. Në total, vlera e prokuruar është 2,640,900 lekë pa TVSH. E njëjta situatë paraqitet edhe për vitin 2019 ku nga 13 procedura prokurimi të realizuara me vlerë të vogël, 4 prej tyre i përkasin një grupi mallrash të ngjashëm dhe konkretisht procedurat e prokurimit me objekt “Blerje dokumente specifik” me vlerë 796,500 lekë pa TVSH, “Blerje shtypshkrime” me vlerë 396,600 lekë pa TVSH, “Blerje kancelari” me vlerë 448,410 lekë pa TVSH dhe “Blerje tonerash” me vlerë 684,200 lekë pa TVSH. Në total, vlera e prokuruar është 2,325,710 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: Nenin 28, pika 2 dhe neni 40, pika 1 e ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006 i ndryshuar “Për prokurimin publik”; Nenin 40, pika 1 dhe pika 8 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Pikën 3, të udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, i ndryshuar “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.	17-20	E lartë	<i>Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat që në të ardhmen të mos copëzohen fondet për grup mallrash të ngjashëm duke shmangur në këtë mënyrë kryerjen e procedurave normale të prokurimit në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi.</i>
4.	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare për periudhën e auditimit 01.01.2018 deri 31.12.2019 dhe që kanë pasur si objekt riparimin, mirëmbajtjen apo shërbime të sistemeve IT, u konstatua se, DPD ka			

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	<p>shpenzuar nga buxheti i saj 2,674,420 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Konkretisht Drejtoria e Përgjithshme Detare:</p> <p>-Për vitin 2018, edhe pse në stafin e saj nuk disponon specialist IT, komisioni i blerjeve të vogla, ka konstatuar një modem jashtë funksionit duke kryer riparimin e tij me shpenzimet e veta në vlerën e 11.500 lekë me TVSH (blerje emergjente) likuiduar sipas urdhër xhirimit nr. 95, datë 16.05.2018. Në vazhdim, me urdhër prokurimi nr. 1065/1 prot., datë 13.06.2018, është iniciuar procedura e prokurimit me objekt <i>“Riparim pajisje navigacionale”</i> duke lidhur kontratën me nr. 1065/2 prot., datë 29.06.2018 me operatorin ekonomik òL.D.ò SHPK, dhe vlerë 897,840 lekë me TVSH. Njësoj është vepruar nga DPD edhe për kryerjen e një blerjeje emergjente me objekt <i>“Riparim i sistemit të brendshëm të internetit”</i> duke shpenzuar 106,800 lekë me TVSH sipas faturës nga òL.D.ò SHPK me nr. 339, datë 11.10.2018 dhe urdhër xhirimit me të njëjtën vlerë me nr. 212, datë 08.11.2018.</p> <p>-Për vitin 2019, është kryer procedura e prokurimit me objekt <i>“Aksesi në internet”</i> sipas urdhër prokurimit nr. 231/1 prot., datë 22.01.2019 dhe në vazhdim DPD ka lidhur me operatorin ekonomik òN.ò SHPK, kontratën me nr. 231/2 prot., datë 31.01.2019 për ofrimin e shërbimit të internetit me vlerë kontrate 540,000 lekë me TVSH sipas faturës me nr. 686, datë 26.02.2019 dhe urdhër xhirimit nr. 45, datë 11.03.2019. Në vazhdim, me urdhër prokurimi nr. 1414/1 prot., datë 26.04.2019, është iniciuar procedura e prokurimit me objekt <i>“Riparim pajisje navigacionale”</i> duke lidhur kontratën me nr. 1414/2 prot., datë 06.05.2019 me operatorin ekonomik òO.A.ò me administrator z. K.L. dhe vlerë 710,400 lekë me TVSH sipas faturës nr. 06, datë 13.05.2019 dhe urdhër xhirimit nr. 98, datë 16.05.2019. Gjithashtu, DPD ka iniciuar në vazhdim procedurën e prokurimit me objekt <i>“Riparim kompjuter, printer, fotokopjo”</i> sipas urdhër prokurimit nr. 1582/1 prot., datë 17.06.2019 duke lidhur kontratën me nr. 1582/2 prot., datë 05.07.2019 me operatorin ekonomik òO.A.ò me administrator z. K.L. dhe vlerë 407,880 lekë me TVSH sipas faturës me nr. 08, datë</p>	17-20	E lartë	<p><i>Drejtoria e Përgjithshme Detare, të marrë masat e nevojshme, për të bashkëpunuar me AKSHI-n, referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke eliminuar kostot e panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve IT.</i></p>

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	<p>12.07.2019 dhe urdhër xhirimit nr. 156, datë 19.07.2019. Komisionet e blerjeve të vogla, në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve mbështetëse dhe sektorin juridik të DPD-së, përpara fillimit të çdo procedure prokurimi për mirëmbajtjen apo shërbimin e sistemeve IT të institucionit, duhej ti referoheshin VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” e ndryshuar dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018’ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 2,674,420 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efijensës, ekonomicitetit dhe efektivitetit.</p>			
5.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me zbatimin e kontratës me nr. 6811, datë 03.12.2018, të lidhur midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik oR.C.ö SHPK me përfitues Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe objekt “Vendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi”, u konstatua se për implementimin e sistemit, DPD ka likuiduar vlerën prej 68,933,400 lekë me TVSH sipas urdhër xhirimeve me nr. 171, datë 07.08.2019 dhe vlerë 4,832,050 lekë me TVSH; nr. 172, datë 07.08.2019 dhe vlerë 1,546,950 lekë me TVSH; nr. 186, datë 23.08.2019 dhe vlerë 5,339,950 lekë me TVSH; nr. 187, datë 23.08.2019 dhe vlerë 281,050 lekë me TVSH; nr. 270, datë 04.12.2019 dhe vlerë 30,754,730 lekë me TVSH dhe nr. 271 datë 04.12.2019 dhe vlerë 1,618,670 lekë me TVSH. Për mirëmbajtjen e sistemit apo riparimin e tij, DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj 1,267,200 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Konkretisht Drejtoria e Përgjithshme Detare, ka likuiduar sipas dy urdhër xhirimeve me nr. 273, datë 10.12.2019 dhe nr. 274, datë 10.12.2019, 1,267,200 lekë për mirëmbajtjen e sistemit IT të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi për periudhën Mars 2019 deri Tetor 2019.</p>	20-23	E lartë	<p><i>Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël si dhe eliminimin e kostove të panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.</i></p>

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	NË RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	Drejtoria e shërbimeve mbështetëse, sektori juridik, sektori i financës së DPD-së, përpara fillimit të çdo procedure/praktike likuidimi për mirëmbajtjen apo shërbimin e sistemeve IT të institucionit, duhej ti referoheshin VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" e ndryshuar dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 'Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018' të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 1,267,200 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efikasë, ekonomicitetit dhe efektivitetit.			
6.	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës lidhur me grupin e menaxhimit të riskut, për periudhën objekt auditimi, DPD nuk kishte caktuar Grupin e Menaxhimit të Risqeve dhe planin e veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 81a, 10 dhe 211 2, të ligjit nr. 102961 2010, i ndryshuar dhe nuk është caktuar koordinatori i risqeve në fushat e këtij institucioni.	29-30	E mesme	<i>Drejtoria e Përgjithshme Detare, nëpunësi autorizues të marrë masa që të caktohet Grupi për Menaxhimin e Riskut dhe të miratojë koordinatorin e riskut të institucionit, konform përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 "Menaxhimi i riskut", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Institucioni ta rishikojë çdo vit dhe përditësojë Grupin për Menaxhimin e Riskut dhe koordinatorin e riskut.</i>

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Drejtorisë së Përgjithshme Detare Durrës për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2019 është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Krahas parregullsive materiale sasiore, në arritjen e opinionit, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

Në përfundim të auditimit, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, rezulton se nuk ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator, situatë e cila justifikon dhënien e një **opinionit të pakualifikuar të përputhshmërisë.**

Baza për opinionin e pakualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

Konkluzionet dhe opinionet ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 (Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë), ISSAI 1500 (ISA 500) dhe ISSAI 1530 (ISA 530) ; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të DPD Durrës:

Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme Detare Durrës, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme Detare Durrës janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objekti i auditimit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e

sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 283/1 prot., datë 11.03.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, ndryshuar me shkresën me nr. 283/2 prot., datë 30.04.2020, ndryshuar me shkresën me nr. 283/3 prot., datë 05.05.2020, ndryshuar me shkresën me nr. 283/4 prot., datë 19.06.2020, ndryshuar me shkresën me nr. 283/5 prot., datë 30.06.2020, nga data 11.03.2020¹ deri në datën 10.07.2020, në subjektin “Drejtoria e Përgjithshme Detare, Durrës” (DPD), për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2019, u krye auditimi mbi zbatimin e përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme Detare Durrës, me autorizimin nr. 283/9 prot, datë 14.12.2021 “Autorizim për auditim dhe plotësim evidenca auditimi”, me përbërje:

1. A.T., Përgjegjës Grupi
2. I.B., Audituese

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Objekti kryesor i auditimit ka të bëjë me vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator, që qeverisin subjektin e audituar. Ky auditim, ka pasur në fokus, nëse një çështje e veçantë është në përputhje me kuadrin rregullator, të identifikuar si kriter. Ky kuadër rregullator mund të përfshijë rregulla, ligje dhe rregullore, rezoluta buxhetore, politika, kode të vendosura, kushte të dakordësuara ose parime të përgjithshme, që rregullojnë menaxhimin e duhur financiar në institucionin e DPD-së dhe sjelljen e stafit të institucionit (*sipas ISSAI 100, p 22, faqe 165*).

2. Qëllimi i auditimit

Auditimi promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të autoriteteve, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Ky auditim promovon qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku ka ligje dhe rregullore të pamjaftueshme ose joadekuate. Qëllimi i Auditimit është hartimi i Raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve për periudhën nga data 01.01.2018 deri me datë 31.12.2019, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të shoqërisë.

3. Identifikimi i çështjes:

Drejtoria e Përgjithshme Detare, si institucion i financiar nga buxheti i shtetit, duhet të ketë organizimin e duhur, të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për rritjen e cilësisë së shërbimit dhe të ketë në konsideratë shpenzimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Drejtoria e Përgjithshme Detare, është institucion i financiar nga Buxheti i Shtetit. DPD, është autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikat e zhvillimit të

¹ Auditimi filloi në datën 06.05.2020 pra 2 muaj më vonë se data e përcaktur në program sipas protokollit të takimit të parë për shkak të pandemisë COVID-19.

transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit për fushën e detarisë. DPD ka personalitet juridik dhe ushtron detyrat e përgjegjësitë e saj në përputhje me Ligjin 10109, datë 02.04.2009, òPër Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditim të cilat duhet të jenë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI duke respektuar kërkesat etike si dhe duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Kombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 òMbi Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e ndryshuar; Ligji nr.160/2014, datë 27.11.2014 òPër buxhetin e vitit 2018 ò të ndryshuar; Ligji nr.147/2015, òPër buxhetin e vitit 2019 ò të ndryshuar; Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 òPër sigurimet shoqërore në RSH, të ndryshuar; Ligji nr.7870, datë 13.10.1994 òPër Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publik, i ndryshuar;

Ligji 10109, datë 2.04.2009 òPër Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 9251, datë 8.07.2004 òKodi Detar i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, etj.

7. Standardet e auditimit

Raporti Përfundimtar i Auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 ó 165);
- Ligjin nr. 154/2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400 - Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 - Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë;
- ISSAI 1500 (ISA 500) - Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530) - Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI òPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë;

8. Metodatat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të

çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Verifikimi i transaksioneve* ó mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;
- b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- c. *Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikuat me drejtimet e auditimit;
- d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 óDokumentimi i Auditimitö, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Drejtoria e Përgjithshme Detare, është institucion i financuar nga Buxheti i Shtetit dhe autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikat e zhvillimit të transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit për fushën e detarisë. DPD është institucion buxhetor publik, që ka personalitet juridik dhe ushtron detyrat e përgjegjësitë e saj në përputhje me Ligjin nr. 10109, datë 02.04.2009, òPër Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk ka në përbërje njësi shpenzuese, por në administratën e saj funksionojnë njësi administrative si Kapiteneria e portit Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë të cilat kryejnë funksionin e tyre ligjor jashtë territorit të njësisë qendrore të DPD-së Durrës. Shpenzimet për Kapiteneritë ashtu si dhe për strukturën tjetër, pjesë përbërëse e strukturave organizative të miratuara nga Kryeministri, kryhen të përqendruara në DPD Durrës. Është audituar aktiviteti i institucionit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar shpenzime për personelin dhe paga e dieta, vendimet e marra nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD-së, të ardhurat e realizuara si dhe realizimi i shpenzimeve. Janë audituar procedurat e prokurimit si dhe zbatimi i kontratave përkatëse dhe procedurat me blerje të vogël. Është audituar hartimi i pasqyrave financiare, programi i zhvillimit, dhënia me qira e ambienteve në dispozicion të shoqërisë etj.

Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2018 deri në 31.12.2019, DPD ka kryer 27 procedura prokurimi me vlerë të vogël ku për vitin 2018 vlera e prokuruar është 8,891,984 lekë me TVSH dhe për vitin 2019 vlera e prokuruar është 7,062,872 lekë me TVSH.

Të ardhurat totale të DPD për vitin 2018, janë 11,635,667.88 lekë të cilat përfshijnë Taksat Portuale në vlerën 873,042.88 lekë, Tarifë për Pasaportë Lundrimi në vlerën e 1,943,500 lekë, Qira Objekti *(në godinën e DPD-së ka një ambient ku ushtrohej një aktivitet privat për kafe, sqaruar në pikën për të ardhurat dytësore të DPD-së)* në vlerën 144,000 lekë, Shërbime të ndryshme *(certifikata dhe leje lundrimi)* në vlerën 8,352,500 lekë, Të tjera nga shitja e mallrave në vlerën 7,625 lekë *(shitje metalesh për skrap)*, Gjoha *(për kundërvajtje të operatorëve që operojnë në fushën e detarisë)* në vlerën 315,000 lekë.

Të ardhurat totale të DPD për vitin 2019, janë 10,265,407.47 lekë të cilat përfshijnë Taksat Portuale në vlerën 858,470.97 lekë, Tarifë për Pasaportë Lundrimi në vlerën e 1,943,500 lekë, Qira Objekti *(në godinën e DPD-së ka një ambient ku ushtrohej një aktivitet privat për kafe, sqaruar në pikën për të ardhurat dytësore të DPD-së)* në vlerën 144,000 lekë, Shërbime të ndryshme *(certifikata dhe leje lundrimi)* në vlerën 6,976,800 lekë, Gjoha *(për kundërvajtje të operatorëve që operojnë në fushën e detarisë)* në vlerën 342,636.5 lekë.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit òNr. 283/1, datë 11.03.2020ò, u shqyrtua dokumentacioni i realizimeve dhe mos realizimeve të rekomandimeve të auditimit të mëparshëm,

Drejtoria e Përgjithshme Detare është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për vitet 2015 dhe 2016 për të cilin Raporti përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 21/8, datë 17.05.2017. Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH, konstatohet se ky afat është zbatuar me urdhrin nr. 09/2011, datë 23.05.2017, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò. Për sa i përket zbatimit të afatit 6-mujor për raportin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatohet se nuk është zbatuar nga DPD në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014,

datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò. Në datën 09.11.2017, një grup auditimi i KLSH-së, ka mbajtur Akt Verifikimin nr. 1, datë 09.11.2017 mbi zbatimin e rekomandimeve nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, ku ka rezultuar se nga 21 masa organizative të rekomanduara, 1 është zbatuar, 3 nuk janë zbatuar dhe 17 masa janë në proces. Nga 2 masa për shpërblim dëmi, janë zbatuar 2 dhe nga 4 masa disiplinore, janë zbatuar 4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga auditimi në mënyrë të njëpasnjëshme dhe me zgjedhje, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve nga DPD, për përmirësimin e gjendjes është si më poshtë:

Nr.	Masat	Rekomanduar	Në proces	Realizuar	Pa zbatuar	Jashtë kompetence
1.	Masa organizative	21	7	12	-	1
2.	Shpërblim dëmi	2	-	2	-	-
3.	Masa disiplinore	4	-	-	4	-

**1.1 Titulli i gjetjes:
Situata:**

Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, u konstatua se, DPD i ka kthyer përgjigje Kontrollit të Lartë të shtetit brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 09/2011, datë 23.05.2017. Me dt. 09.11.2017, KLSH ka audituar zbatimin e realizimit të rekomandimeve të lënë në auditimin e mëparshëm nga ku ka rezultuar se nga 21 masa organizative të rekomanduara, 1 është zbatuar, 3 nuk janë zbatuar dhe 17 masa janë në proces. Nga 2 masa për shpërblim dëmi, janë zbatuar 2, dhe nga 4 masa disiplinore, janë zbatuar 4. Aktualisht, nga auditimi i realizimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, ka rezultuar se:

A. Janë rekomanduar 21 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 12 masa, janë në proces 7 masa, pjesërisht zbatuar 1 rekomandim dhe 1 rekomandim është kompetencë e Ministrisë.

B. Janë rekomanduar 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën totale prej 290,089.8 lek, të cilat janë zbatuar.

C. Janë rekomanduar 4 masa disiplinore dhe asnjë prej tyre nuk është zbatuar.

Kriteri: Ligji 154/2014 òPër organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.

Ndikimi/efekti: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga grupi i mëparshëm i auditimit sjell për pasojë pa rregullsi në mbarëvajtjen e aktivitetit të institucionit të DPD-së.

Shkaku: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi 1.1.1 Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masa që në të ardhmen të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të KLSH për përmirësimin e situatës brenda afateve të përcaktuara sipas detyrimeve ligjore.

2.2 Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese, përputhshmëria ligjore e vendimeve.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit nr. 283/1 prot., datë 11.03.2020, u shqyrtuan me zgjedhje vendimet e marra nga Drejtori i DPD-së dhe njëkohësisht korrespondenca me Ministrinë e Linjës.

Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, është institucion buxhetor në varësi të ministrit. Drejtoria e Përgjithshme Detare drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka autoritetin dhe përgjegjësinë për marrjen e të gjitha vendimeve në fushën e detarisë, që nuk janë kompetencë ekskluzive e ministrit në konformitet me nenin 13 të ligjit nr. 10109, datë 02.04.2009 *“Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e administratës detare të Republikës së Shqipërisë bazohet në legjislacionin në fuqi për fushën e detarisë, si dhe në marrëveshjet e konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë. Drejtoria e Përgjithshme Detare drejton dhe organizon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për fushën e detarisë, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 10 109, datë 02.04.2009 *“Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Detare, është z. P.N., i emëruar në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm sipas shkresës me nr. 2367/2 prot., datë 12.04.2018 protokolluar tek DAP dhe nr. 78/2 prot., datë 17.04.2018 protokolluar në DPD.**

Për periudhën objekt auditimi, nga Drejtori i DPD, janë nxjerrë 115 urdhra për vitin 2018 dhe 139 urdhra për vitin 2019. Më poshtë, pasqyrohen një pjesë e tyre të përzgjedhur nga grupi i auditimit.

Drejtori i DPD, kryen funksionet e tij konform nenit 14, të Ligjit nr. 10 109, datë 02.04.2009 *“Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë”*.

Për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2018, nga Drejtori i DPD-së, janë nxjerrë në total 115 urdhra ekzekutimi për strukturat përbërëse të administratës detare, të cilët kanë pasur si objekt krijimin e komisioneve të prokurimit të blerjeve të vogla, lirim dhe emërimin nga detyra të nëpunësve të DPD-së, ngritje grupe pune për verifikime të incidenteve të ndryshme apo të dokumenteve të operatorëve që operojnë në fushën e detarisë, etj.

Për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2019, nga Drejtori i DPD-së, janë nxjerrë në total 139 urdhra ekzekutimi për strukturat përbërëse të administratës detare, të cilët kanë pasur si objekt krijimin e komisioneve të prokurimit të blerjeve të vogla, lirim dhe emërimin nga detyra të nëpunësve të DPD-së, ngritje grupe pune për verifikime të incidenteve të ndryshme apo të dokumenteve të operatorëve që operojnë në fushën e detarisë, etj. Në akt konstatimin e mbajtur nga grupi i auditimit për këtë pikë, janë trajtuar disa mangësi administrative për nxjerrjen e urdhrave nga Drejtori i DPD-së me fuqi prapavepruese, por për arsye se zbatimi i këtyre urdhrave nuk ka sjellë asnjë pasojë negative për institucionin, nuk do të trajtohen në hartimin e këtij Raporti. *(Subjekti është vënë në dijeni për këto mangësi dhe ka marrë masat për korrigjimin e praktikave të ndjekura më parë).*

2.3 Mbi planifikimin, hartimin dhe realizimin e planit vjetor financiar dhe të biznesit si dhe raportimi i tyre.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar.

Dokumenti i PBA-së, pasqyron kërkesat buxhetore të ministrive të linjës duke paraqitur me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve prej secilës prej Ministrive të linjës për vitet 2018 dhe 2019.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 201 dhe për vitin 2019, është mbështetur në parimin e planifikimit buxhetor sipas Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" si dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2018 dhe vitit 2019.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë" si dhe udhëzimeve përkatëse, është bërë planifikimi i kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), për periudhën 2018-2019. Në anekset bashkangjitur, gjeni tabelat përkatëse.

Projekt Buxheti Afatmesëm për të dy vitet 2018 dhe 2019, është mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 06.08.2014 *“Për tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm, UMFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PEA” si dhe bazuar në UMFE nr. 7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”.* Tek anekset, gjeni tabelën përkatëse.

Për periudhën objekt auditimi 2018-2019, nga sektori i financës janë kryer rakordimet me Degën e Thesarit Durrës, (*1. Rakordimi mujor i të ardhurave 1 Janar - 31 Dhjetor 2018 dhe 2019; 2. Rakordimi me datë 29.01.2019 dhe 23.01.2020 mbi 5% garanci për defekte që trashëgohen për vitin 2019 dhe 2020; 3. Rakordimi me datë 14.01.2019 dhe 10.01.2020 mbi llogarinë 466 “Mjete në ruajtje” që trashëgohen për vitin 2019 dhe 2020*), nga ku janë mbajtur dhe konfirmuar nga të dy palët situacionet përkatëse në nivel artikulli për çdo muaj konform përcaktimeve në udhëzimin e zbatimit të buxhetit. Nga Drejtoria e Përgjithshme Detare janë plotësuar formularët e raporteve të monitorimit për çdo tremujor dhe janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuara në MTI. Këto raporte nuk janë të shoqëruara me analizën e treguesve financiarë si dhe të objektivave dhe produkteve përkatëse.

3.1.Titulli i gjetjes: Në Projekt buxhetet e hartuara nuk janë plotësuar formularët për kërkesat shtesë mbi tavanet limit të miratuara dhe raportet e monitorimit nuk janë shoqëruar me analiza të treguesve si dhe të objektivave e produkteve përkatëse.

Situata: Nga auditimi i projektbuxhetit të dërguar nga DPD për vitin 2018 dhe vitin 2019 në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, u konstatua se ai nuk është shoqëruar me një analizë të objektivave për vitin si dhe me produktet për realizimin e objektivave. Gjithashtu në kërkesat për buxhet, nuk rezultojnë të plotësuar formularët për kërkesat shtesë mbi tavanet limit të miratuara dhe argumentimin e domosdoshmërisë së këtyre fondeve, me qëllim alokimin e tyre nga Ministria e Financave sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, VKM nr. 185, datë 29.03.2018 *“Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”*, Aneksi 1, UMF nr. 22, datë 17.11.2016 *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”*.

Kriteri: Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*; Ligji 10296 dt. 8.7.2010 *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*; Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 *“Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”*; Udhëzimi Nr. 10 datë 13.07.2017 *“Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018 - 2020”* dhe Udhëzimi nr.8, datë 29.03.2012 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”*.

Ndikimi/efekti: Mungesa e një analizë me argumentet e plota dhe mosplotësimi i formularëve për kërkesat shtesë mbi tavanet limit ndikon alokimin e buxhetit të DPD-së si dhe në masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e treguesve buxhetorë.

Shkaku: Mos veprim i strukturave përkatëse të DPD-së.

Rëndësia:

E Lartë.

Rekomandimi 3.1.1

Drejtoria Ekonomike e DPD-së, të marrë masa që gjatë hartimit të PBA-së, të plotësohen formularët për fondet jashtë tavaneve të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave referuar nevojave për investime, mallra e shërbime mbi këto tavane si kusht për mundësinë e çeljeve të fondeve për plotësimin e këtyre nevojave si dhe të merren masa për një planifikim e menaxhim të koordinuar të buxheteve vjetore me ato të PBA. PBA dhe raportet e monitorimit të shoqërohen me analiza të treguesve si dhe të objektivave e produkteve përkatëse.

2.4 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, është institucion buxhetor në varësi të ministrit. Drejtoria e Përgjithshme Detare drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka autoritetin dhe përgjegjësinë për marrjen e të gjitha vendimeve në fushën e detarisë, që nuk janë kompetencë ekskluzive e ministrit. Veprimtaria e administratës detare të Republikës së Shqipërisë bazohet në legjislacionin në fuqi për fushën e detarisë, si dhe në marrëveshjet e konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë. Drejtoria e Përgjithshme Detare drejton dhe organizon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për fushën e detarisë, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 10 109, datë 02.04.2009 òPër Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Detare, është z. P.N., i emëruar në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm sipas shkresës së DAP me nr. 2367/2 prot., datë 12.04.2018 dhe nr. 78/2 prot., datë 17.04.2018 DPD. Drejtoria e Përgjithshme Detare, funksionon sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 73, datë 21.04.2016 dhe shkresës nr. 130/4 prot., datë 22.04.2016 në të cilën është reflektuar shkurtimi i pozicionit të IT nga Sektori Juridik Shërbimeve burimeve njerëzore dhe shërbimeve. Struktura e miratuar, është e përbërë nga:

-Drejtori i Përgjithshëm.

-Zv. Drejtor i Përgjithshëm/Kapiten i Porteve.

-Kapiteneritë e Porteve & Kontrolli Shtetëror Portual, Kapiteneria e Portit Durrës, Kapiteneria e Portit Vlorë, Kapiteneria e Portit Shëngjin, Kapiteneria e Portit Sarandë, Sektori i Kontrollit Shtetëror Portual, Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional.

-Drejtoria (Autoriteti Shtetëror) e Sigurisë Detare, Sektori i Inspektimit të Sigurisë Detare & Kontrollit të Flamurit, Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese & Detare, Sektori i Mjedisit Detar Marrëdhënieve me Institucionet & i Konventave Ndërkombëtare.

-Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Juridik Burimeve Njerëzore & Shërbimeve, Sektori i Financës.

Numri total i pozicioneve i miratuar nga Kryeministri sipas organigramës dhe shkresës me nr. 130/4 prot., datë 22.04.2016, është 71.

Në vazhdim, me shkresën nr. 130/32 prot., datë 09.11.2016, Kryeministri dërgon ndryshimet në strukturë duke ndërhyrë tek Drejtoria (Autoriteti Shtetëror) e Sigurisë Detare dhe sektorët përkatës.

2.5 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi përputhshmërinë e kryerjes së shpenzimeve në lekë e valutë. Kryerja e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet e vogla (shpenzimet administrative për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë

vendit, sponsorizime, shpenzimet e marketingut, komisione e bonuse, penaltete, gjoba etj.).

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit nr. 283/1 prot., datë 11.03.2020,

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni i pagesave të bankës.

Dokumentacioni hyrjeve dhe daljeve të magazinës.

Dokumentacioni i mbajtur mbi marrjen në dorëzim të furnizimeve për të gjithë periudhën e auditimit.

Për vitin 2018, është krijuar komisioni i blerjeve të vogla sipas urdhrin nr. 1 të datës 03.01.2018 të përbërë nga B.Ç., B.Ç. dhe H.H..

Për vitin 2018, janë parashikuar sipas regjistrin të parashikimeve me nr. 69/8 prot., datë 19.01.2018, 22 procedura prokurimi me vlerë të vogël. Nga këto, DPD ka realizuar 14 procedura prokurimi me vlerë të vogël me vlerë totale 8,891,984 lekë me TVSH. Janë audituar të gjitha procedurat e realizuara ose 100 % e tyre.

Për vitin 2019, është krijuar komisioni i blerjeve të vogla sipas urdhrin nr. 1 të datës 03.01.2019 të përbërë nga B.Ç., B.Ç. dhe M.K..

Për vitin 2019, janë parashikuar sipas regjistrin të parashikimeve me nr. 23 prot., datë 11.01.2019, 14 procedura prokurimi me vlerë të vogël. Nga këto, DPD ka realizuar 13 procedura prokurimi me vlerë të vogël me vlerë totale 7,062,872 lekë me TVSH.

Nga auditimi (100% i praktikave) lidhur me shpenzimet sipas pikës 5 të programit të auditimit për periudhën nga 01.01.2018 deri 31.12.2019, u konstatua:

5.1 Titulli i gjetjes: Copëzim fondi për grup mallrash të ngjashëm në procedurat e prokurimit për blerjet e vogla.

Situata: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme Detare, për vitin 2018 14 procedura prokurimi me vlerë totale të prokuruar 8,891,984 lekë me TVSH nga të cilat 4 procedura kanë objekte që i përkasin një grupi mallrash të ngjashëm dhe kapin vlerën e 2,640,900 lekë pa TVSH. Konkretisht nga komisioni i blerjeve të vogla, janë copëzuar fondet për procedurat e prokurimit me objektet “*Blerje dokumente specifik*” me vlerë 797,900 lekë pa TVSH, “*Blerje shtypshkrime*” me vlerë 387,800 lekë pa TVSH, “*Blerje kancelari*” me vlerë 758,200 lekë pa TVSH dhe “*Blerje tonerash*” me vlerë 697,000 lekë pa TVSH. E njëjta situatë paraqitet edhe për vitin 2019 ku nga 13 procedura prokurimi të realizuara me vlerë totale të prokuruar 7,062,872 lekë me TVSH, 4 procedura kanë objekte që i përkasin një grupi mallrash të ngjashëm me vlerë totale të prokuruar prej 2,325,710 lekë pa TVSH dhe konkretisht procedurat e prokurimit me objekt “*Blerje dokumente specifik*” me vlerë 796,500 lekë pa TVSH, “*Blerje shtypshkrime*” me vlerë 396,600 lekë pa TVSH, “*Blerje kancelari*” me vlerë 448,410 lekë pa TVSH dhe “*Blerje tonerash*” me vlerë 684,200 lekë pa TVSH.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.12.2006 i ndryshuar “*Për prokurimin publik*”, neni 28, pika 2 dhe neni 40, pika 1;
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 40, pika 1;
Udhëzimi nr. 3 i APP, datë 27.01.2015 i ndryshuar “*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*”, pika 3.

Ndikimi/efekti: Krijohen kushte për përdorimin e fondeve publike pa efijencë,

	ekonomicitet dhe efektivitet.
Shkaku:	Shmangie e kryerjes së procedurave normale të prokurimit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 5.1.1	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat që në të ardhmen të mos copëzohen fondet për grup mallrash të ngjashëm duke shmangur në këtë mënyrë kryerjen e procedurave normale të prokurimit në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi.
5.2. Titulli i gjetjes:	Mungesa e argumentimit dhe dokumentimit të përlogaritjes së vlerës së kontratës.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në vitin 2018 përkatësisht 14 procedura me vlerë totale të realizuar prej 8,891,984 lekë me TVSH dhe vitin 2019 përkatësisht 13 procedura me vlerë totale të realizuar prej 7,062,872 lekë me TVSH, u konstatuan parregullsi për sa i përket justifikimit të fillimit të procedurës pasi mangësitë e evidentuara kishin të bënin me mungesat e argumentimit dhe dokumentimit të nevojës për kryerjen e disa procedurave. Komisionet e blerjeve të vogla, nuk disponojnë asnjë argument apo dokumentacion lidhur me nevojën e blerjes së mallrave ose me nevojën e kryerjes së një shërbimi apo riparimi. Për rastet e kryerjes së procedurave për blerje mallrash, rezulton se DPD nuk ka dokumentuar nevojën duke verifikuar fillimisht gjendjen e këtyre mallrave në magazinë ose duke ju referuar kërkesave për blerje mallrash nga njësitë e vartësisë. E njëjta situatë paraqitet edhe për procedurat e prokurimit për kryerjen e riparimeve apo shërbimeve për të cilat nuk u evidentua asnjë argumentim lidhur me defektet e ndodhura përpara se të kërkohej prokurimi i riparimit të pajisjeve apo zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara sipas zërave përkatës për riparim ose shërbim.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 40, pika 3, paragrafi dytë dhe neni 59, fjalia e fundit.
Ndikimi/efekti:	Mund të krijohen kushte për shpenzime me efekte negative për buxhetin e Shtetit.
Shkaku:	Neglizhenca në kryerjen e procedurave paraprake verifikuese.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi 5.2.1	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat që në të ardhmen, përpara fillimit të kryerjes së procedurave të prokurimit për blerje mallrash apo riparime pajisjesh, të justifikojë/argumentojë paraprakisht me dokumentacion vërtetues nevojën e kryerjes së shërbimit/riparimit apo të blerjes së mallrave me qëllim shmangien e kryerjes së shpenzimeve për mallra apo shërbime të pa nevojshme për institucionin.
5.3. Titulli i gjetjes:	Shpenzime nga buxheti i DPD-së për shërbime mirëmbajtjeje të sistemeve IT jo në përputhje me parimet e efizienzës, ekonomikitetit dhe efektivitetit të fondeve publike.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare për periudhën e

auditimit 01.01.2018 deri 31.12.2019 dhe që kanë pasur si objekt riparimin, mirëmbajtjen apo shërbime të sistemeve IT, u konstatua se, DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj 2,674,420 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Konkretisht Drejtoria e Përgjithshme Detare:

-Për vitin 2018, edhe pse në stafin e saj nuk disponon specialist IT, komisioni i blerjeve të vogla, ka konstatuar një modem jashtë funksionit duke kryer riparimin e tij me shpenzimet e veta në vlerën e 11.500 lekë me TVSH (blerje emergjente) likuiduar sipas urdhër xhirimit nr. 95, datë 16.05.2018. Në vazhdim, me urdhër prokurimi nr. 1065/1 prot., datë 13.06.2018, është iniciuar procedura e prokurimit me objekt *“Riparim pajisje navigacionale”* duke lidhur kontratën me nr. 1065/2 prot., datë 29.06.2018 me operatorin ekonomik òI.D.ò SHPK, dhe vlerë 897,840 lekë me TVSH. Njësoj është vepruar nga DPD edhe për kryerjen e një blerjeje emergjente me objekt *“Riparim i sistemit të brendshëm të internetit”* duke shpenzuar 106,800 lekë me TVSH sipas faturës nga òI.D.ò SHPK me nr. 339, datë 11.10.2018 dhe urdhër xhirimit me të njëjtën vlerë me nr. 212, datë 08.11.2018.

-Për vitin 2019, është kryer procedura e prokurimit me objekt *“Aksesi në internet”* sipas urdhër prokurimit nr. 231/1 prot., datë 22.01.2019 dhe në vazhdim DPD ka lidhur me operatorin ekonomik òN.ò SHPK, kontratën me nr. 231/2 prot., datë 31.01.2019 për ofrimin e shërbimit të internetit me vlerë kontrate 540,000 lekë me TVSH sipas faturës me nr. 686, datë 26.02.2019 dhe urdhër xhirimit nr. 45, datë 11.03.2019. Në vazhdim, me urdhër prokurimi nr. 1414/1 prot., datë 26.04.2019, është iniciuar procedura e prokurimit me objekt *“Riparim pajisje navigacionale”* duke lidhur kontratën me nr. 1414/2 prot., datë 06.05.2019 me operatorin ekonomik òO.A.ò me administrator z. K.L. dhe vlerë 710,400 lekë me TVSH sipas faturës nr. 06, datë 13.05.2019 dhe urdhër xhirimit nr. 98, datë 16.05.2019. Gjithashtu, DPD ka iniciuar në vazhdim procedurën e prokurimit me objekt *“Riparim kompjuter, printer, fotokopjo”* sipas urdhër prokurimit nr. 1582/1 prot., datë 17.06.2019 duke lidhur kontratën me nr. 1582/2 prot., datë 05.07.2019 me operatorin ekonomik òO.A.ò me administrator z. K.L. dhe vlerë 407,880 lekë me TVSH sipas faturës me nr. 08, datë 12.07.2019 dhe urdhër xhirimit nr. 156, datë 19.07.2019. Komisionet e blerjeve të vogla, në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve mbështetëse dhe sektorin juridik të DPD-së, përpara fillimit të çdo procedure prokurimi për mirëmbajtjen apo shërbimin e sistemeve IT të institucionit, duhej ti referoheshin VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”* e ndryshuar dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”* të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej **2,674,420 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit.**

Kriteri:	VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” e ndryshuar, pika 5, germa (gj) dhe germa (i), pika 6, germa (dh) dhe germa (i), pika 18 deri 24. Udhëzimi Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018’ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pika 18, germa (a), (b), (c) dhe (d).
Ndikimi/efekti:	Mos përdorimi i këtij shpenzimi për investime të tjera të domosdoshme për Drejtorinë e Përgjithshme Detare.
Shkaku:	Neglizhenca në kryerjen e procedurave paraprake verifikuese/informuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 5.3.1	Drejtoria e Përgjithshme Detare, të marrë masat e nevojshme, për të bashkëpunuar me AKSHI-n, referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke eliminuar kostot e panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve IT.

Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi, anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla sipas viteve dhe përkatësisht B.Ç., B.Ç., M.K. dhe H.H..

2.6 Mbi Zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave.

-Me shkresën nr. 6899 prot., datë 05.12.2018, protokolluar tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe nr. 1106/31 prot., datë 20.12.2018 protokolluar tek DPD, AKSHI i dërgon për zbatim Drejtorisë së Përgjithshme Detare, kontratën nr. 6811, datë 03.12.2018, të lidhur midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik òR.C.ò SHPK me përfitues Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe objekt “Vendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi”. Kontrata është me nr. 6811 prot., datë 03.12.2018, me vlerë sipas nenit 2 të kontratës 76,536,600 lekë me TVSH. Sipas shtojcës nr. 1, të kontratës, likuidimi do të kryhet në dy faza. Faza e parë për implementimin e sistemit, fillon me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon pas 3 muajsh. Vlera e implementimit me TVSH është 68,933,400 lekë. Faza e dytë, mirëmbajtja e sistemit, përfundon pas 48 muajsh nga nënshkrimi i kontratës dhe vlera e mirëmbajtjes për 4 vite, është 7,603,200 lekë me TVSH.

Nga verifikimi i pagesave të kryera nga DPD në llogari të operatorit ekonomik òR.C.ò SHPK, u konstatua:

-Për implementimin e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi janë likuiduar sipas urdhër xhirimeve të mëposhtme vlera prej 68,933,400 lekë me TVSH dhe konkretisht:

-Urdhër xhirimi nr. 252, datë 28.12.2018 dhe vlerë të likuiduar 24,560,000 lekë me TVSH. (Fatura nr. 384, datë 21.12.2018 me vlerë 30,939,000 lekë me TVSH. Bashkangjitur është situacioni dhe fletë-hyrja e mallrave me nr. 2, datë 21.12.2018. procesverbali i marrjes në dorëzim është me datë 21.12.2018 dhe i firmosur nga personat e autorizuar T.H. për DPD-në dhe A.H. për AKSHI-n me detyrë Përgjegjës i sektorit IT në Ministrinë e Mbrojtjes.)

-Urdhër xhirimi nr. 171, datë 07.08.2019 dhe vlerë të likuiduar 4,832,050 lekë me TVSH.

-Urdhër xhirimi nr. 172, datë 07.08.2019 dhe vlerë të likuiduar 1,546,950 lekë me TVSH. (Fatura

është me nr. 384, datë 21.12.2018 dhe vlerë 30,939,000 lekë me TVSH.)

-Urdhër xhirimi nr. 186, datë 23.08.2019 dhe vlerë të likuiduar 5,339,950 lekë me TVSH.

- Urdhër xhirimi nr. 187, datë 23.08.2019 dhe vlerë të likuiduar 281,050 lekë me TVSH.
- Urdhër xhirimi nr. 270, datë 04.12.2019 dhe vlerë të likuiduar 30,754,730 lekë me TVSH.
- Urdhër xhirimi nr. 271 datë 04.12.2019 dhe vlerë të likuiduar 1,618,670 lekë me TVSH.
(Fatura është me nr. 43, datë 03.03.2019 dhe vlerë 30,939,000 lekë me TVSH.)
- Për mirëmbajtjen e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi janë likuiduar sipas urdhër xhirimeve të mëposhtme vlera prej 1,267,200 lekë me TVSH dhe konkretisht:
- Urdhër xhirimi nr. 273 datë 10.12.2019 dhe vlerë të likuiduar 633,600 lekë me TVSH.
(Fatura është me nr. 300, datë 04.07.2019.)
- Urdhër xhirimi nr. 274 datë 10.12.2019 dhe vlerë të likuiduar 633,600 lekë me TVSH.
(Fatura është me nr. 436, datë 04.11.2019.)

6.1. Titulli i gjetjes: Shpenzime nga buxheti i DPD-së për mirëmbajtjen e sistemit IT të projektit *“Vendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi (LRIT)”*, jo në përputhje me parimet e efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të fondeve publike.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me zbatimin e kontratës me nr. 6811, datë 03.12.2018, të lidhur midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik òR.C.ò SHPK me përfitues Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe objekt *“Vendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi”*, u konstatua se për implementimin e sistemit, DPD ka likuiduar vlerën prej 68,933,400 lekë me TVSH. Për mirëmbajtjen e sistemit apo riparimin e tij, DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj 1,267,200 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Konkretisht Drejtoria e Përgjithshme Detare, ka likuiduar sipas dy urdhër xhirimeve me nr. 273, datë 10.12.2019 dhe nr. 274, datë 10.12.2019, 1,267,200 lekë për mirëmbajtjen e sistemit IT të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi për periudhën Mars 2019 deri Tetor 2019.

Drejtoria e shërbimeve mbështetëse, sektori juridik, sektori i financës së DPD-së, përpara fillimit të çdo procedure/praktike likuidimi për mirëmbajtjen apo shërbimin e sistemeve IT të institucionit, duhej ti referoheshin VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”* e ndryshuar dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 *‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018’* të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej **1,267,200 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit.**

Nga verifikimi i kryer në DPD sipas autorizimit për Auditim dhe Plotësim Evidencash Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme Detare

Durrës me nr. 283/9 Prot., datë 14.12.2021, u evidentua se DPD nuk ka likuiduar për vitin 2021 vlerën prej 2,320,601 lekë për kryerjen e investimit me objekt *“Vazhdim i sinjalit satelitor LRIT”*, shpenzim i cili i është miratuar nga MIE me shkresën nr. 8113/3 Prot., datë 26.11.2021. Këtë vlerë të miratuar me kaq vonesë, DPD nuk ka mundur ta shfrytëzojë për arsye të kohës në dispozicion për kryerjen e procedurave të prokurimit. Sinjali satelitor, është ndërprerë de-jure, në datën 03.03.2021, sipas shkresës së DPD-së dërguar AKSHI-t. Shkresa me nr. 308 Prot., datë 02.03.2021 dërguar AKSHI-t, cilëson se sinjali satelitor do të ndërpritet në datën 03.03.2021 duke i kërkuar AKSHI-t, prokurimin e këtij shërbimi. Në përgjigjen që ka kthyer AKSHI me shkresën me nr. 1420/1 Prot., datë 19.03.2021 AKSHI dhe nr. 308/1 Prot., datë 23.05.2021 DPD, nuk ka pranuar që ta kryejë prokurimin por i ka thënë DPD që ta kryejë vet DPD këtë prokurim me justifikimin se *“Shërbimi satelitor për lidhjen e terminaleve LRIT me sistemin e serverëve LRIT nuk është specifikisht pjesë e fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, objekt i veprimtarisë së AKSHI-t”*. Procedura e prokurimit e zhvilluar nga AKSHI në vitin 2018, ka pasur të përfshirë edhe sinjalin satelitor tek zëri sipas ofertës *“F.V. Software Shërbimi LRIT dhe detyrimet për certifikimet e IMO (24 muaj)”* dhe *“F.V. Raportimi Automatik i Pozicionit LRIT (24 muaj)”* Por këto komponentë të kontratës bazë, AKSHI i ka pas prokuruar për 24 muaj kurse mirëmbajtjen e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve e ka pas prokuruar për 48 muaj. Pra është prokuruar mirëmbajtja e një sistemi për 48 muaj në të njëjtën kohë që sistemi do jetë funksional vetëm për 24 muaj. AKSHI me të njëjtën logjikë që ka refuzuar këtë prokurim, mund të refuzonte edhe prokurimin me objekt *“Vendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi”* të kryer në vitin 2018 pasi edhe ky objekt nuk është *“specifikisht”* në fushën e IT por AKSHI e ka prokuruar, pra nga sa më sipër duket qartazi se AKSHI ka funksionuar me dy standarde ose ka prokuruar mirëmbajtjen e sistemeve të cilat në momentin që dalin jashtë funksionit (data 03.03.2021), vazhdojnë të mirëmbahen.

Kriteri: VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”* e ndryshuar, pika 5, germa (gj) dhe germa (i), pika 6, germa (dh) dhe germa (i), pika 18 deri 24.

Udhëzimi Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 *‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018’* të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pika 18, germa (a), (b), (c) dhe (d).

Ndikimi/efekti: Mos përdorimi i kësaj vlere për investime të tjera të domosdoshme për Drejtorinë e Përgjithshme Detare.

Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e procedurave paraprake verifikuese/informuese.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi 6.1.1 Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël.

Rekomandimi 6.1.2 Drejtoria e Përgjithshme Detare, në bashkëpunim me AKSHI-n dhe MIE, të marrin masa për mbulimin e shpenzimeve për zërin òF.V. Raportimi Automatik i Pozicionit LRITò për periudhën Mars-Dhjetor 2021 dhe garantimin e funksionimit të sistemit nga AKSHI me kontrata shumë vjeçare të cilat të jenë njësoj në kohë si për mirëmbajtjen e sistemit por edhe të raportimit automatik për të siguruar funksionimin pa mangësi të sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi.

Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse znj. F.I., Shefi i Sektorit të Financës z. H.H. dhe Specialisti i Sektorit Juridik të DPD-së z. K.B..

2.7 Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të institucionit, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit nr. 283/1 prot., datë 11.03.2020, për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si vijon: *Pasqyrat financiare të DPD për vitin 2018 dhe 2019, Evidenca kontabël e Shoqërisë (librat, regjistrat kontabël, etj.) për vitin 2018, 2019 Ditari i regjistrimit të veprimeve të kryera, Dokumentacioni shoqëruar i veprimeve kontabël, Dokumentacionet justifikuese, etj.*

Është respektuar afati i dorëzimit të bilancit për vitin 2018 në Degën e Thesarit Durrës me shkresën përcjellëse nr. 986, datë 19.03.2019 si dhe dorëzimi i bilancit për vitin 2019 me shkresën përcjellëse nr. 1036, datë 18.03.2020. Pasqyrat financiare janë shoqëruar me shënimet shpjeguese për raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit. Dega e Thesarit Durrës ka vulosur çdo faqe të pasqyrave financiare të vitit 2018 dhe vitit 2019.

Auditimi i llogarive për vitin 2018 dhe për vitin 2019.

Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare për vitet 2018 dhe 2019, është bërë në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ò i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.

Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Veprimet kontabël në këtë institucion, kryhen në mënyrë elektronike me programin kompjuterik “*financa 5*”. Nga verifikimi i veprimeve për mbylljen e pasqyrave financiare rezulton se në llogaritë sintetike, nuk janë hedhur me korrektësi llogaritë analitike dhe për rrjedhojë llogaritë sintetike nga programi i kontabilitetit ose llogaritë e gjendjeve për vitin 2018 dhe vitin 2019, nuk janë të barabarta me llogaritë e hedhura në pasqyrat financiare të Aktivit dhe të Pasivit.

Theksojmë se shumat e llogarive të paraqitura në postet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar, korrespondojnë me informacionin që jepet në Pasqyrat e tjera Financiare dhe Anekset e Pasqyrave financiare. Po ashtu dhe shumat e paraqitura në Pasqyrën Financiare të Lëvizjes së Mjeteve Monetare (CASH FLOW), janë të rakorduara me situacionet faktike të pagesave dhe arkëtimeve.

7.1 Mbi pasqyrat financiare të vitit 2018

Nga verifikimi i veprimeve për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2018, rezulton se llogaritë sintetike nuk kuadrojnë me llogaritë e hedhura në programin financiar të kontabilitetit. Në anekset bashkangjitur, ndodhen tabelat respektive.

Nga analiza e llogarive të bilancit të vitit 2018 të DPD-së, rezulton se:

Shuma e aktivitetit të bilancit, pasqyron aktivet e qëndrueshme, aktivet qarkulluese, kërkesat për tu arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit, që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Aktivi i bilancit i institucionit të DPD-së, në fund të vitit 2018 është 310,007,984.88 lekë i barabartë me pasivët e bilancit. Të dhënat e aktivitetit të bilancit për vitin 2018 nuk kuadrojnë me llogaritë e gjendjeve të regjistruara në programin e kontabilitetit.

Aktivi i bilancit, rezulton në shumën 310,007,984.88 lekë. Aktivi i programit të kontabilitetit, rezulton në shumën 312,615,813.88 lekë. Diferenca, në shumën 2,607,829 lekë. Grupi i auditimit, konstatoi se diferenca 2,607,829 lekë, është si rezultat i zërit “aktive qarkulluese” në zërat analitikë të tij dhe ka diferenca si më poshtë:

1. Llogaria “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët”, diferenca në shumën 4,271 lekë është diferenca e detyrimeve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për taksën portuale të kreditorëve d.m.th. të klientëve, pra kjo diferencë ju takon klientëve. Kjo shumë, është e pasqyruar në procesverbalin e mbajtur midis DPD-së dhe degës së Thesarit Durrës e cila zerohet (u paguhet klientëve) në janarin e vitit të ardhshëm (pra të vitit 2019).

2. Në zërin llogari financiare në bilanc, rezulton shuma 3,903,007.88 lekë, ndërsa në programin financiar shuma 6,515,107.88 lekë. Diferenca 2,616,371 lekë, përbëhet nga llogaritë “Mjete në ruajtje për pasaportë lundrimi” dhe “Mjete në ruajtje për taksën portuale”. Në programin e kontabilitetit, këto dy llogari rezultojnë në shumën 2,816,542 lekë. Kjo shumë përbëhet nga Mjete në ruajtje për pasaporta lundrimi me shumë 1,943,500 lekë dhe llogaria “Mjete në ruajtje për taksën portuale në shumën 873,042.88 lekë, nga ku rezulton një diferencë në shumën 204,442 lekë e cila është shumë që është transferuar në janarin e vitit që vjen (në janarin e vitit 2019).

Në zërin aktive afatgjata materiale të bilancit, nuk ka diferenca nga programi i kontabilitetit financiar. Ato rezultojnë në shumën 279,187,246 lekë.

Shuma e investimit të Aktiveve Afatgjata Materiale, është 44,860,010 lekë. Objektet e investimeve të kryera, kanë qenë; “Ndërtimi i sistemit LRIT” dhe “Rikonstruksioni Godinës së Kapitenerisë Shëngjin”. Këto investime, deri në fund të vitit 2018, kanë qenë në proces në llogarinë 231 dhe konkretisht në shumën 33,881,724 lekë. Kanë vazhduar në vitin 2018 duke ju rritur vlera me 10,978,286 lekë dhe janë marrë në dorëzim, në prill të vitit 2019, duke u regjistruar nga aktive në proces në zërin Aktive Afatgjata Materiale.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 ka ndryshuar në ulje edhe llogaria 215 Mjete transporti si rezultat i rritjes së vlerës së amortizimit të tyre me 80,151,060 lekë. Kjo ka çuar në ndryshimin e vlerës neto të mjeteve të transportit në 27,381,100 lekë nga kostoja historike 107,532,160 lekë. Shifrat e vendosura në pasqyrën e aktivitetit të bilancit për AQT dhe AQ të patrupëzuara, rakordojnë me formatin nr. 7/a të pasqyrave financiare “Gjendja dhe ndryshimet e AQ”.

Llogaritë e Pasivit të bilancit, për vitin 2018, janë të barabarta me llogaritë e aktivitetit në shumën 310,007,984.88 lekë. Kjo shumë, përbëhet nga llogaritë e fondeve të veta, pra 293,010,450 lekë dhe nga llogaritë e detyrimeve afatshkurtra ose 16,463,530.88 lekë.

Në llogaritë e gjendjeve të programit sintetik të kontabilitetit të institucionit, fondet e veta, janë në shumën 293,286,294.18 lekë. Detyrimet afatshkurtra janë në vlerën e 16,463,530.88 lekë. Nga auditimi, rezultoi se ka një moskuadrim të fondeve të veta të paraqitura në bilanc në shumën prej 276,702 lekë, krahasuar me shumën e fondeve të veta të paraqitura në programin financiar të institucionit.

Për vitin 2018, Drejtoria e Përgjithshme Detare, ka në pasiv zërin “Llogari të pagueshme” zë i cili, është llogari detyrimesh afatshkurtra. Në këtë llogari, futen detyrimet e pagave, sigurimeve dhe tatimet mbi të ardhurat personale (TAP). Shumat e tyre, pasqyrojnë detyrimet vetëm për muajin dhjetor. Shuma në Llogarinë 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” është në vlerën 4,171,611 lekë. Pagesa e tyre, është bërë në janarin e vitit të ardhshëm d.m.th. në vitin 2019.

Llogaritë 435 dhe 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përkatësisht në vlerat 1,262,248 lekë dhe 176,174 lekë, paraqesin kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP (tatim mbi të ardhurat personale) në shumën 432,519 lekë. Këto shuma përfaqësojnë pagat e muajit Dhjetor 2018, të cilat janë likuiduar në janar 2019, me fondet buxhetore të planifikuara për vitin buxhetor.

Nga grupi i auditimit, u bë verifikimi i llogaritjes së amortizimit sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, nga ku rezultoi se llogaritja dhe kontabilizimi i amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, është kryer sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për Përgatitjen dhe Raportimin e Llogarive Vjetore të vitit 2006, për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive të Menaxhim-Zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj”, të ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 14, datë 28.12.2006”. Fondi i amortizimit për vitin 2018, është në vlerën 206,866,577 lekë. Më shumë, ky fond ngarkohet për ndërtesat në shumën 49,133,042 lekë, mjete transporti në shumën 80,151,060 lekë, pajisje dhe vegla pune në shumën 49,133,042 lekë, inventari ekonomik në shumën 11,963,078 lekë dhe amortizim rrjeti në shumën 49,769 lekë. Këto vlera të fondit të amortizimit të paraqitura në bilancin e vitit 2018, janë të barabarta me fondin e amortizimit të paraqitur në programin e kontabilitetit financiar.

Nga DPD, janë plotësuar dhe pasqyrat e tjera financiare si formati 3/1 ku pasqyrohen shpenzimet korrente 6 % më të ulëta se një vit më parë ose në vlerën 87,448,038 lekë (për vitin 2018), nga të cilat pagat e personelit me shtesat, zënë rreth 63 milion lekë ose 68 %; kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore rreth 10 milion lekë ose 11 % dhe mallra e shërbime rreth 17 milion lekë ose 15 %.

Në formatin 3/2 “Të ardhura të ushtrimit” jepet informacion mbi të ardhurat e përdorura për vitin 2018, që kapin vlerën 99,974,925 lekë, të cilat përbëhen kryesisht nga granti i brendshëm (Financim nga Buxheti). Gjithashtu vlera e ndryshimit të gjendjes së inventarit kuadron me llogarinë 63 ÷ ndryshim gjendjeo dhe me pasqyrat e inventarit të vitit 2018 (në shumën 3,751,385 lekë).

Në fund të pasqyrave financiare jepen shpjegime për rubrikat e plotësuara, bashkëlidhur pasqyrave financiare janë të vendosura situacionet e konfirmuara nga thesari për të ardhurat dhe shpenzimet.

7.2 Mbi pasqyrat financiare të vitit 2019

Edhe për këtë vit, dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar mbështetur në dispozitat përkatëse në fuqi. Nga verifikimi i veprimeve për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2019 rezultoi se, llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike dhe janë të hedhura korrektësisht në pasqyrat financiare të Aktivit dhe të Pasivit. Pasqyrat financiare të vitit 2019, janë të shoqëruara me situacionin e të ardhurave dhe shpenzimeve të konfirmuara nga thesari si dhe nxjerrjen e thesarit të datës 31.12.2019. Në anekset bashkangjitur, ndodhen tabelat respektive.

Në programin e kontabilitetit financiar të DPD-së, për vitin 2019, shuma e llogarive të pasivit është 20,141,713 lekë. Ndryshimi i shifrave midis llogarive të pasivit të bilancit dhe llogarive të pasivit të programit të kontabilitetit financiar, përbëhet nga diferencat: 292,751,548 lekë në llogarinë “Fondet e veta”, 198,880 lekë në llogarinë “Detyrimet afatshkurtra” dhe 416,150

lekë në llogarinë “Detyrime të tjera”. Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit, rezultoi moskuadrim i llogarisë “Fonde të veta” të paraqitura në bilanc në shumën 292,751,548 lekë me shumën e llogarisë “Fonde të veta” të paraqitur në programin financiar të DPD-së. Llogaria 212, “Ndërtime e konstruksione” paraqitet në fund të vitit 2019, në vlerën prej 137,283,459 lekë. Theksojmë se DPD, ka ndryshim të llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” gjatë vitit 2019 në shumën 172,988,845 lekë, një rritje kjo, që ka ardhur si rezultat i shtimit të investimeve, të cilat janë regjistruar në këtë llogari.

Gjithashtu gjatë vitit 2019 ka ndryshuar në ulje dhe llogaria 215 òmjete transportiò, si rezultat i rritjes së vlerës së amortizimit në vlerën 85,627,280 lekë, duke ndryshuar kështu vlera neto e mjeteve të transportit në 21,904,880 nga vlera e kostos historike që ishte 107,532,160 lekë.

Gjithashtu në programin e kontabilitetit në llogarinë 581 “Xhirime të brendshme”, ekziston një diferencë në debi të kësaj llogarie, në shumën 1,831,732 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se edhe kjo shumë është e trashëguar nga vitet e mëparshme. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme Detare, nuk kryen veprime nëpërmjet arkës. Grupi i auditimit, analizoi edhe zërat kryesorë të buxhetit, duke i krahasuar me gjendjen në kontabilitet në fund të vitit ushtrimor për vitin 2018 dhe vitin 2019.

7.1 Titulli i gjetjes: Diferenca ndërmjet gjendjeve në pasqyrat financiare dhe të dhënave të paraqitura nga programi i kontabilitetit për vitin 2018 dhe vitin 2019.

Situata 1: Nga auditimi u konstatuan mospërputhje/mangësi dhe konkretisht për vitin 2018, të dhënat e aktivitetit të bilancit, nuk kuadrojnë me llogaritë e gjendjeve të regjistruara në programin e kontabilitetit, me një diferencë në shumën 2,607,829 lekë. (Aktivi i bilancit rezulton në shumën 310,007,984.88 lekë, ndërsa Aktivi i programit të kontabilitetit në shumën 312,615,813.88 lekë).

Në klasën 1 të llogarive (Fondet e veta), zëri òfondet bazëò nuk rakordon: të dhënat e bilancit janë në shumën 293,010,450 lekë, ndërsa të dhënat në programin e kontabilitetit janë në shumën 293,286,294.18 lekë - me një diferencë prej 276,702 lekësh.

Për vitin 2019 janë konstatuar mospërputhje/mangësi,

- Shuma e llogarive të aktivitetit në bilanc rezulton me një diferencë në programin e kontabilitetit të DPD është në shumën 320,752,536 lekë;

- Nga krahasimi i Pasivit të pasqyrave financiare (bilancit) me të dhënat në programin e kontabilitetit: të dhënat e bilancit janë në shumën 300,686,149 lekë ndërsa të dhënat e programit të kontabilitetit për pasivin janë 20,141,743 lekë, pra rezulton një diferencë prej 292,751,548 lekë (diferencë e cila rrjedh nga diferencat prej 292,751,548 lekë òfondi bazëò, 198,880 lekë òaktive afatshkurtraò dhe 416,150 lekë òllogari të tjeraò.

- Diferenca në zërin òinventarëò në vlerën 1,043 lekë (shuma në bilanc është 16,121,150 lekë, ndërsa në programin e kontabilitetit është 16,120,107 lekë).

Situata 2: Informacionet sqaruese të pasqyrat financiare (bilancet) për vitin 2018, 2019 nuk kishin shënimet shpjeguese të plota me zberthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo problemet që kanë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Situata 3:	Diferencat e zërave të llogarive të kontabilitetit të mbajtur me programin Financa 5 me zërat e llogarive të raportuara në pasqyrat financiare të trajtuara më sipër, janë tregues i mungesës së rregullave të kontrollit të veprimeve financiare dhe të mosfunksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në DPD, siç kërkohet në Ligjin ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm neni 5, neni 8 (pikat 1, 8), neni 20 dhe neni 22.
Kriteri:	-Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö . -Ligji 9228 date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. -Standardet Kombëtare të Kontabilitetit”.
Ndikimi/efekti:	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandim 7.1.1:	Nga Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, Sektori i Financës, të merren masa për sistemimin e diferencave të fondeve të veta, të cilat duhet të jenë të barabarta me pasqyrimin e tyre në bilanc; të dhënat e pasqyrave financiare (bilanci) të klasës 1 të llogarive ÷fondet e veta dhe huatö të rakordohen me të dhënat në programin të kontabilitetit financiar. Gjithashtu të merren masa për saktësimin e detyrimeve afatshkurtra si detyrime, likuidimi i të cilave duhet të bëhet brenda një viti ose një cikli operativ (ekonomik) duke përdorur aktivet e veta afatshkurtra ose duke krijuar detyrime të tjera afatshkurtra. Të kryhen veprimet përkatëse rregulluese kontabël në llogaritë kreditore për detyrimet ndaj furnitorëve, ndaj detyrimeve tatimore e të tjera në vijimësi dhe të bëhet pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2020.
Rekomandim 7.1.2:	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, Sektori i Financës, të marrë masa për plotësimin e pasqyrave financiare me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore me informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve. Shënimet të japin përshkrime me fjalë apo zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
Rekomandim 7.1.3:	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masa për të përcaktuar rregulla që forcojnë kontrollin e brendshëm lidhur me rakordimin dhe raportimin e zërave të llogarive të kontabilitetit të mbajtur me programin Financa 5 dhe raportimin e tyre në mënyrë rigoroze mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen, të cilat të përputhen me zërat e llogarive të raportuara në pasqyrat financiare.
Rekomandim	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masa për të

7.1.4: përcaktuar rregulla që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e zërave të llogarive të kontabilitetit të mbajtur me programin Financa 5 dhe raportimin e tyre në mënyrë rigoroze mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen, të cilat të përputhen me zërat e llogarive të raportuara në pasqyrat financiare.

Sa më sipër, është mbajtur akt-konstatimi nr. 7 dhe nr. 8 si dhe plotësime të tjera gjatë hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit referuar dokumentacionit të mbledhur nga DPD dhe të shqyrtuar pas dorëzimit në KLSH të observacioneve të ardhura në lidhje me akt-konstatimet e mbajtura dhe Projekt Raportin e Auditimit.

7.2.Titulli i gjetjes: Mos rakordimi i faktit të buxhetit me faktin në kontabilitetin financiar për vitet 2018 dhe 2019.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga DPD lidhur me pasqyrat financiare dhe Pasqyrat e realizimit të buxhetit si për vitin 2018 ashtu edhe për vitin 2019, grupi i auditimit konstatoi një mospërputhje të faktit të realizimit të buxhetit me faktin e pasqyruar në pasqyrat e kontabilitetit. Konkretisht, ky konstatim u vu re në zërin e shpenzimeve kapitale ku për vitin 2018, fakti i realizimit të buxhetit për shpenzimet kapitale, është 35,538 mijë lekë dhe fakti i regjistruar në pasqyrat financiare, është 44,859 mijë lekë. Pra me një diferencë prej 10,679 mijë lekë. Gjithashtu, edhe për vitin 2019, fakti i realizimit të buxhetit për shpenzimet kapitale, është 44,374 mijë lekë ndërsa fakti i regjistruar në kontabilitet, është 0 lekë. Pra me një diferencë prej 10,679 mijë lekë. Këto mospërputhje, kanë ardhur si rezultat i moskuadrimit të llogarive analitike me llogaritë sintetike (të gjendjeve) që pasqyrohen në pasqyrat financiare në fund të vitit.

Kriteri: Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Ndikimi/efekti: Tejkalmi i fondeve nga institucioni duke mos raportuar shtesa për fonde publike.

Shkaku: Mos zbatimi i Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi 7.2.1: Drejtoria e Përgjithshme Detare, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i financës, të marrin masa që të bashkëpunojë midis tyre për raportimet faktike të buxhetit me kontabilitetin financiar.

2.8 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe auditit të brendshëm.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik të DPD duke mos zbatuar kërkesat e Ligjit 10296 dt.08.07.2010 për ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjik me detyre trajtimin e çështjeve që lidhen me MFK.

DPD nuk ka hartuar planet e veprimit për vitin 2018, 2019 me objektiva përkatëse, nevojat, masat e propozuara dhe afatet, strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Në Drejtorinë e Përgjithshme Detare nuk ka strukturë të auditimit të brendshëm duke qenë se është një agjenci buxhetore dhe me numër të vogël punonjësish, auditimi i brendshëm për këtë drejtori kryhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

8.1 Titulli i Gjetjes: Nuk është caktuar Grupi i Menaxhimit të Riskut dhe as koordinatori i risqeve në Drejtorinë e Përgjithshme Detare Durrës.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës lidhur me grupin e menaxhimit të riskut, për periudhën objekt auditimi, DPD nuk kishte caktuar Grupin e Menaxhimit të Risqeve dhe planin e veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 81a, 10 dhe 211 2, të ligjit nr. 102961 2010, i ndryshuar dhe nuk është caktuar koordinatori i risqeve në fushat e këtij

Kriteri: -Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
-Manuali "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 1089, datë 17.11.2016;
-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.16, datë 20.07.2016;

Rëndësia E lartë

Rekomandimi 8.1.1 Drejtoria e Përgjithshme Detare, nëpunësi autorizues të marrë masa që të caktohet Grupi për Menaxhimin e Riskut dhe të miratojë koordinatorin e riskut të institucionit, konform përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 "Menaxhimi i riskut", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Institucioni ta rishikojë çdo vit dhe përditësojë Grupin për Menaxhimin e Riskut dhe koordinatorin e riskut.

8.2 Titulli i Gjetjes: Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në praktikë nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe mungon një strategji për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës lidhur me strategjinë për menaxhimin e risqeve, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se DPD nuk kishte hartuar Strategjinë për Menaxhimin e Risqeve dhe planin e veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 81a, 10 dhe 211 2, të ligjit nr. 102961-2010, i ndryshuar. Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të negativ për përmbushjen e objektivave, rezulton se nuk janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontroleve ekzistuese dhe nevojave për kontrole të reja, por nuk janë hartuar për çdo zotërues e sektor, nuk është përditësuar regjistri i risqeve.

Kriteri: -Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
-Manuali "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 1089, datë 17.11.2016;
-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.16, datë 20.07.2016;

Rëndësia
Rekomandimi 8.2.1

E lartë
Drejtoria e Përgjithshme Detare, nëpunësit autorizues dhe zbatues të marrin masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Ministrinë e linjës për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve për arritjen e objektivave të vendosura, konform përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 "Menaxhimi i riskut", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Institucioni të rishikojë çdo vit dhe përditësojë Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioriteteve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata bazë që ky institucion ka.

2.9 Kontroll mbi administrimin dhe bazueshmërinë ligjore të administrimit të pronës.

DPD nuk ka dokument të që të vërtetojë se AQT në llogarinë 212 ÷Ndërtime dhe rikonstruksione÷ janë në pronësi apo në administrim të kësaj Drejtorie. Nga DPD janë kryer plan rilevimet për disa ndërtesa të cilat janë në kapitaneritë e rretheve Vlorë, Shëngjin, Sarandë, rilevime të cilat janë bërë për efekte të kryerjes në periudhat në vazhdim të rikonstruksioneve të tyre. Planet e rilevimit janë dokumente kryesorë që ZVRPP të mund të japin informacion mbi gjendjen e pronësisë mbi të cilat institucionet kanë në përdorim (në pronësi apo administrim) dhe kryejnë funksionet e tyre

Referuar inventarit të AQT për ndërtesat rezultoi se DPD Durrës ka në përdorim: ndërtesë + truall dhe kullë vrojtimi në Kapitenerinë Durrës, Ndërtesë + truall në kapitenerinë Vlorë, ndërtesë + truall në kapitenerinë Shëngjin dhe Sarandë.

Mos marrja e masave për regjistrimin e inventarit në përdorim nga DPD është tregues i menaxhimit jo të mirë të aseteve të njësisë publike që bie ndesh me:

Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin÷, neni 4, pika 1 dhe pika 19 dhe Udhëzimin nr. 30 datë ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik÷, pika 10, pika 26 ku thuhet ÷çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura÷. Ligji nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar.

9.1 Titulli i Gjetjes

DPD nuk ka dokumente justifikues që të vërtetojë se AQT në llogarinë 212 ÷Ndërtime dhe rikonstruksione÷ janë në pronësi apo në administrim të kësaj Drejtorie.

Situata

Pasqyrat financiare nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje për sa i takon gjendjes në llogarinë ÷ndërtime dhe konstruksione÷.

Kriteri

- Ligji nr. 10296, datë 8.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin÷, neni 4, pika 1 dhe pika 19
- Udhëzimi nr. 30 datë ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik÷, pika 10, pika 26 ku thuhet ÷çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura÷.

- Ligji nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive te paluajtshme", i ndryshuar,

Ndikimi/Efekti Mos marrja e masave për regjistrimin e inventarit në përdorim nga DPD është tregues i administrimit, ruajtjes dhe dokumentimit jo të mire të vlerave të aseteve të njësisë publike.

Rëndësia E lartë

Rekomandimi 9.1.1 DPD, sektori i financës dhe sektori juridik të marrin masat administrative dhe ligjore për regjistrimin e aseteve në pronësi dhe pasqyrimin e tyre të drejtë në pasqyrat financiare.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi F.I. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

2.10 Mbi auditimin e krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore, bazuar në kuadrin rregullator ligjor.

Drejtorja e Përgjithshme Detare Durrës gjatë kryerjes së funksioneve të sajë ligjore realizon të ardhura edhe si agjent i qeverisë për vjeljen e taksës kombëtare të Taks portuale dhe tarifë për të Pasaportë lundrimi, të ardhura që referuar akteve rregullative në fuqi derdhen çdo muaj në llogarinë përkatëse të tatimeve. Tarifat për shërbimet e kryera nga veprimtaria kryesore e DPD janë miratuar me aktet si më poshtë vijon :

1- Shkresa e Ministrisë së transporteve me nr.68/3, datë 9.02.2001

2-Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit nr.10, date 30.01.2009 si dhe me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 5938/1, date 21.02.2000.

Nga auditimi rezulton se të ardhurat e realizuara nga vetë Drejtorja e Përgjithshme Detare për vitin 2018, 2019, dhe 3 mujori I - 2020 janë si më poshtë:

Tab. 10

000/lekë

Nr.	Periudha	Te Ardhura	
1.	Viti 2018	11,635	
2.	Viti 2019	10,265	
3.	Viti 2020 (3 muj. I-rë)	1,170	

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Referuar tabelës më sipër të ardhurat e realizuara në vitin 2018 janë më të larta se të ardhurat e vitit 2019, sepse në vitin 2018 janë arkëtuar gjobat nga subjektet që kishin detyrim, ndërsa për vitin 2019 nuk ka patur gjoba për detyrime të vonuara nga subjektet.

Nga auditimi me zgjedhje në lidhje me saktësinë e paraqitjes së të ardhurave të arkëtuara kundrejt dokumentacionit të lëshuar rezultoi se nuk ka devijacione.

Të ardhurat e grumbulluara për Taksën Portuale dhe Tarifën për pasaportë lundrimi janë derdhur si shpenzim nga llogaria e të ardhurave në thesar në llogarinë e tatimeve, kundrejt formularëve dhe afateve të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 16.12.2014 dhe për disa shtesa dhe ndryshimeve në udhëzimin nr.26, date 04.09.2008 dhe për taksat kombëtare, të ndryshuar.

Përveç këtyre të ardhurave DPD realizon dhe të ardhura dytësore nga veprimtaria kryesore e saj, ku referuar dokumentacionit standard të miratuar numërohen 15 lloje të ardhurash. Këto të ardhura që konsiderohen të ardhura nga veprimtaria kryesore e njësisë, derdhen 100 % në buxhetin e shtetit.

Të ardhurat e realizuara në vitin 2018 janë 14 % më të larta se ato të realizuara në vitin 2019, të cilat kanë rrjedhur nga zëri shërbime për dokumente lundrimi sipas tarifave të miratuara, 19 % më i lartë 2018/19.

Në kuadër të llojeve të shërbimeve si detyrime që duhet të kryejë DPD referuar kompetencave që i jep Kodi detar i Republikës së Shqipërisë, DPD në vitin 2011 nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm i është drejtuar Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, për ngritjen e një grupi pune për rishikim të kuadrit ligjor dhe treguesve ekonomik financiar të të ardhurave që mund të përfitojë kjo drejtori kundrejt shërbimeve dhe tarifave të vendosura, referuar dhe tarifave të vendeve Evropiane sigurisht duke krijuar dhe infrastrukturën e domosdoshme: bazuar në llojet e mjeteve të transportit detar të ardhura në territorin e RSH, shërbimeve të kryera dhe tarifimit të këtyre shërbimeve.

Referuar këtyre të dhënave krijohet mundësia e krijimit të të ardhurave të konsiderueshme, që sido që të jetë mënyra e financimit të DPD qoftë me financim buxhetor, qoftë me vetëfinancim, krijojnë kushte favorizuese në sigurimin e të ardhurave dhe një bazë të mirë financiare për ndryshime strukturore, infrastrukture të nevojshme në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e standardeve ndërkombëtare. Pavarësisht kësaj kërkesë, nga ministria nuk ka patur reagime në këtë drejtim.

Të ardhura nga dhënia me qira

Drejtoria e Përgjithshme Detare me shkresat nr.163 prot. datë 07.03.2018 dhe nr.1725/3 prot. date 30.09.2019 ka lidhur kontratë qiraje me Shoqërinë "C. SHPK" përfaqësuar nga administratori z. E.S. dhe Drejtori i Përgjithshëm i DPD Z. P.N. me objekt "Dhënie me qira e një ambienti prej 40 m² për bar-kafe në shërbim të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, sipas planimetrisë bashkëlidhur kontratës për marrjen me qira. Vlera e qirasë është e përcaktuar sipas VKM Nr.54, datë 05.02.2014 (i ndryshuar) për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore. Vlera e qirasë është 450 lekë për m² në muaj ose gjithsej 18 000 lekë në muaj dhe vlera e sigurimit të kontratës është e barabartë me 54,000 lekë.

Ndërmjet DPD dhe subjektit priva afati i kontratës për vitin 2018 është njëvjeçare nga data 07.03.2018 deri me datë 06.03.2019, ndërsa për vitin 2010 afati i kontratës është nga data 01.10.2019 deri me datë 30.03.2020 për një periudhë 6-mujore.

Nga kontrolli i dokumentacionit të kësaj kontrate qiramarrje ndërmjet subjektit C.ö ShPK dhe DPD u konstatua se subjekti qiramarrës nuk ka detyrime ndaj Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe është vepruar konform VKM nr.54, date 5.2.2014 për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore.

2.11 Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modelit nr. 8 "Norma tekniko profesionale dhe metodologjia e shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".

Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të protokollit dhe arkivës për këtë çështje, kriterëve të protokollimit, statistikës së dokumenteve të hyra dhe të dala, inventarit të dosjeve, respektimit të afateve të ruajtjes së dokumenteve, etj. për periudhën nën auditim, rezulton se funksionimi i arkiv-protokoll në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Durrës, është ndërtuar bazuar në Ligjin nr.9154, date 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe Modelit nr. 8 "Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë" të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

2.12 Të tjera çështje që mund të dalin gjatë auditimit.

Në zbatim të pikës 12 të programit të auditimit nr. 283/1, datë 11.03.2020 si dhe duke u bazuar tek informacionet e marra në mënyrë verbale por edhe shkresore, grupi i auditimit ka kryer verifikimet e nevojshme sipas çështjeve të pretenduara. Konkretisht:

-Lidhur me Kapitenerinë e Portit Durrës.

Kapiteneria e Portit Durrës, funksionon sipas ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 883, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”. Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se Kapiteneria e Portit Durrës, ka mbajtur me rigorozitet sipas përcaktimeve ligjore, ditarët dhe dokumentacionin bashkangjitur me anë të të cilit vërtetohen tipet e anijeve që operojnë në Portin e Durrësit dhe që janë të licencuara nga MIE për sa i përket trageteve të linjave të ndryshme “nga” dhe “drejt” Porteve Shqiptare. Lidhur me linjat për automjete dhe pasagjerë, që operojnë në portet e vendit, nga auditimi, ka rezultuar se operojnë agjencitë òD.P.A.ò, òA.F.ò, òG.T.ò, òJ.C.ò, òS.C.ò, òN.M.ò, òG.SH.ò, òV.F.ò dhe òE.S.Ë.ò. Këto agjenci, kanë nënshkruar kontratë me Portet përkatëse dhe pasi liçensohen nga MIE, operojnë me tragetet e tyre sipas një marrëveshjeje për numrin e prekjeve të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë.

-Gjatë auditimit, u konstatua se në kalatën e Portit Durrës, në datën 11.06.2020, ndodhej një traget F/B (F.B.) ku sipas ditarit të Kapitenerisë (të kontrolluar/audituar në të njëjtën datë) rezultoi se kjo anije ishte me numër regjistri 542, me tonazh 7804/3296, me ekuipazh 40 persona dhe pasagjerë 180 persona referuar edhe tek dokumentacioni shoqërues i anijes. Kjo anije, nuk ishte në listën e anijeve të deklaruar nga agjencia òD.P.A.ò në QKB dhe as në vendimet e lëshuara nga MIE për anijet të cilat do operojnë në Portin e Durrësit. Nga verifikimet e kryera, rezultoi se kjo anije ishte zëvendësuese e një prej anijeve të së njëjtës agjenci të cilën e kishin nxjerrë jashtë funksionit përkohësisht duke e ankoruar atë në një prej kalatave të Portit të Durrësit. Në këto raste zëvendësimi, Kapiteneria e Portit Durrës, kishte mbajtur të gjithë dokumentacionin justifikues në konformitet me kreun IV, nenit 13 “Zëvendësimi, shtesa ose prekjet shtesë të mjetit lundrues në një linjë të miratuar” të udhëzimit nr. 883, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, ku përcaktohet se: “1. Në rastet e zëvendësimit të mjeteve lundruese nga mjete të tjera, shtimit të tyre dhe/ose prekjeve shtesë në të njëjtën linjë, subjekti duhet të marrë miratimin nga kapiteneria e portit përkatës, të lidhë kontratë me Portin ose terminalin portual që prek në zbatim të nenit 10, më pas, në zbatim të nenit 8 të këtij udhëzimi dokumentet e mjetit lundrues dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe në zbatim të nenit 9 të këtij udhëzimi, i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme Detare kryerja e inspektimit. Për këto ndryshime Drejtoria e Përgjithshme Detare njofton Ministrinë. 2. Nuk lejohet zëvendësimi i mjeteve lundrues katamaran me tragete dhe anasjelltas.”

-Sa më sipër, bëhet fjalë për një zëvendësim anijesh dhe jo për anije të re. Gjithsesi dokumentacioni i mbajtur nga DPD për këtë zëvendësim, është si më poshtë duke ndjekur radhën hierarkike të hapave sipas përcaktimeve të nenit të mësipërm:

1. Me shkresën nr. 1088 prot., datë 24.04.2020 protokolluar në DPD, òD.P.A.ò, i dërgon drejtorisë së Përgjithshme Detare, kërkesën për zëvendësimin e një anijeje në linjën Durrës-Bari-Durrës duke parashtruar edhe arsyet objektive në këtë kërkesë.

2. Me shkresën nr. 1088/1 prot., datë 06.05.2020, Përgjegjësi i zyrës së regjistrimit të mjeteve lundruese & detare, i paraqet një Memo Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare me anë

të së cilës e informon në lidhje me procedurën e pajisjes me Formular Konformiteti të F/B òR.ò, pas kryerjes së verifikimit të dokumentacionit, në zbatim të Udhëzimit të MIE nr. 883 prot., datë 21.12.2018. Në vazhdim jepen të dhënat e Anijes: Emri-R., Porti Regjistrimit-L., Nr. IMO-9087826, Viti Ndërtimit-1994, Gros Tonage-21646, Pronari-Anthelios Maritime Co, Kompania Menaxhimit-N.M.I. dhe Nr. Identifikimi-5713700.

3. Me shkresën nr. 1088/2 prot., datë 06.05.2020, Drejtori i DPD-së, informon Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur me dokumentacionin e dorëzuar për mjetin lundrues òF.B.R.ò. Në këtë shkresë, paraqitet lista e certifikatave të cilat janë bashkangjitur.

4. Me shkresën nr. 1088/4 prot., datë 22.05.2020, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual, i dërgon Drejtorit të DPD-së, informacionin lidhur me inspektimin në anijen òF.B.R.ò tek i cili përcakton se anija pasagjere òF.B.R.ò, i plotëson kushtet teknike për zhvillimin e aktivitetit për transportin e udhëtarëve dhe/ose pasagjerëve në linjën ndërkombëtare Durrës-Bari-Durrës.

5. Me shkresën nr. 1088/3 prot., datë 22.05.2020, Drejtori i DPD-së, lëshon një vërtetim për mjetin lundrues òF.B.R.ò me nr. IMO 9087826 flamur Qipriot duke cilësuar se ky mjet, plotëson kriteret teknike.

-Lidhur me Kontrollin Shtetëror Portual.

Kjo strukturë e DPD-së, funksionon sipas *ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi detar i Republikës së Shqipërisë"* dhe *udhëzimit nr. 883, datë 21.12.2018 "Për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre"*. Kontrolli Shtetëror Portual, nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion, ka rezultuar se ka kryer për vitin 2018, 17 inspektime duke lëshuar certifikatat përkatëse për sa i përket përmbushjes së standardeve teknike të anijeve që operojnë në Portet e vendit. Edhe për vitin 2019, rezultojnë 26 inspektime. Nga praktikat e audituara, ka rezultuar se Shefi i Zyrës së KSHP z. T.H., ka dërguar pas çdo inspektimi dhe kontrolli të kryer në anije, një relacion tek Titullari i DPD-së z. P.N. me anë të të cilit e ka informuar për hapat e ndjekur gjatë inspektimit në anijet përkatëse sipas rregullores *"Për Kontrollin Shtetëror Portual"*. Të tilla janë informacionet me nr. 445 prot., datë 06.04.2018 lidhur me inspektimin e kryer në anijet F/B BARI, F/B R., A/F M., A/F F., R.S. 1, R.I dhe A/F M. apo me nr. 17 prot., datë 08.01.2019 për anijet e agjencisë òD.P.A.ò të cilat operojnë në linjën Durrës-Bari-Durrës.

-Lidhur me Sektorin e regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare.

Nga auditimi me zgjedhje i këtij sektori, u konstatua se janë mbajtur ditarët e regjistrimit të mjeteve lundruese sipas llojit dhe tipit të mjetit. Nga auditimi i disa praktikave të regjistrimit, u konstatua se ky sektor ka certifikuar mjetin motoskaif me gjatësi 7.40 metra, gjerësi 2.75 metra, zhytje 0.4 metra, nr. serial 4148081, model E200STL sipas certifikatës me nr. 120318112/OB21. Bashkangjitur kësaj certifikatë është i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas përcaktimit të *udhëzimit nr. 883, datë 21.12.2018 "Për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre"*. Njësoj edhe për certifikatat e lëshuara (me zgjedhje) me nr. 051119898/B21964, nr. 060618426MD1 apo nr. 270519347/B21920.

Shpjegime:

Në lidhje me çështjet e tjera të dorëzuara me shkresë pranë grupit të auditimit në datën 29.06.2020, sqarojmë si vijon:

1. Lidhur me dokumentet e drejguara nga Kapiteni i Durrësit T.A. për të mbajtur në treg vetëm një shoqëri ndërkohë që janë dhe 2 kompani të tjera në treg (Referuar edhe shkresës me nr. 1291 prot., datë 15.12.2019 dhe shkresës me nr. 147 prot., datë 11.12.2019)- *(Nga grupi i*

auditimit u krye verifikimi me zgjedhje i këtyre praktikave siç ishte dhe rasti i tragetit R. dhe nuk u konstatuan mangësi me pasoja të rënda për DPD).

2. Lidhur me dosjet personale të stafit të DPD-së (vetëm personave të cilësuar në shkresën e dorëzuar pranë grupit të auditimit) për sa i përket kualifikimeve; (Për këtë çështje, DPD ka dërguar një kërkesë për verifikimin e kualifikimeve pranë MASH me nr. 456 prot., datë 15.09.2017 dhe MASH është përgjigjur për vlefshmërinë e diplomave dhe kualifikimeve për personat e atakuar në informacionin e dhënë, me shkresën me nr. 8753/1 prot., datë 19.02.2018).

3. Lidhur me operimin e tragetit R. ku cilësohet se operon pa licencë (kjo çështje është trajtuar dhe sqaruar në të gjitha hallkat e procesit të auditimit dhe gjykohet e ezauruar për grupin e auditimit);

4. Lidhur me dëshminë e pilotit i cili është dhe anëtar komisioni i këtyre dëshmive; (Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk rezultoi një gjë e tillë.)

5. Lidhur me kryerjen e studimeve me kohë të plotë gjatë kohës që ka qenë i punësuar pranë DPD-së (i referohemi vetëm një rasti); (Nuk u konstatua që punonjësi në fjalë, të mos ketë qenë prezent në punë për periudhën e cilësuar. Fakti që mund të jetë diplomuar në të njëjtën kohë që ka qenë korrekt në punë, mund të jetë shkelje për universitetin dhe jo për DPD-në.)

6. Lidhur me mosparaqitjen në punë të një punonjësi të DPD-së cilësojmë se edhe ky pretendim është sqaruar në të gjitha hallkat e procesit të auditimit;

7. Lidhur me fondet për mirëmbajtjen e LRIT (kjo çështje është trajtuar në akt-konstatimin përkatës);

8. Lidhur me konsumin e karburantit nga DPD (është referuar në akt-konstatimin përkatës për sa i përket dokumentacionit justifikues të dorëzuar pranë grupit të auditimit).

12.1 Titulli i Gjetjes: Inventarët e mjeteve lundruese dhe motorëve të tjerë detarë mbahen në regjistra dhe mungojnë të dhënat dixhitale të tyre (skanimit i këtyre mjeteve).

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës lidhur me inventarët e mjeteve lundruese, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se inventarët e mjeteve lundruese mbahen në mënyrë dokumentare nga drejtoria e sigurisë detare dhe administrimit dhe kontrollit shtetëror (sektori i regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare) dhe punonjësit të cilët gjatë ushtrimit të detyrave funksionale kanë nevojë për këto të dhëna duhet t'ia drejtohen këtij sektori. Nëse DPD do i kishte këto të dhëna të dixhitalizuara, informimi dhe kryerja e detyrave nga punonjësit përkatës do të ishte më efektive.

Kriteri: -Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 4, pikat 9, 12; neni 8;
-Manuali "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 1089, datë 17.11.2016.

Rëndësia E lartë.

Rekomandimi 12.1.1 Drejtoria e Përgjithshme Detare, nëpunësi autorizues, të informojë MIE mbi situatën e inventarizimit të mjeteve lundruese dhe të ndërmarrë hapat me MIE për propozimin dhe ndjekjen e realizimit të një projekti të dixhitalizimit të inventarit të mjeteve lundruese dhe publikimin e tyre në mënyrë elektronike për stafin institucionit.

Shënim: Observacionet e ardhura nga DPD me shkresën nr. 1366/4 prot., datë 28.08.2020 DPD dhe nr. 283/7 prot., datë 02.09.2020 KLSH, cilësojnë se janë të njëjtat me observacionet e dërguara për akt-konstatimet të cilat janë trajtuar në Projekt-Raportin e auditimit e si të tilla nuk ka përse të trajtohen në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, u konstatua se, DPD i ka kthyer përgjigje Kontrollit të Lartë të shtetit brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 09/2011, datë 23.05.2017. Në datën 09.11.2017, KLSH ka audituar zbatimin e realizimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm nga ku ka rezultuar se nga 21 masa organizative të rekomanduara, është zbatuar 1 masë organizative, nuk janë zbatuar 3 masa organizative dhe janë në proces 17 masa organizative. Nga 2 masa për shpërbllim dëmi, janë zbatuar 2 masa dhe nga 4 masa disiplinore, janë zbatuar 4 masa. Aktualisht, nga auditimi i realizimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, ka rezultuar se:

A. Janë rekomanduar 21 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 12 masa, janë në proces 7 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 1 rekomandim dhe 1 rekomandim është kompetencë e Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë.

B. Janë rekomanduar 2 masa për shpërbllim dëmi në vlerën totale prej 290,089.8 lekë, të cilat janë zbatuar.

C. Janë rekomanduar 4 masa disiplinore dhe asnjë prej tyre nuk është zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 12-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës të marrë për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH për përmirësimin e situatës brenda afateve të përcaktuara sipas detyrimeve ligjore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projektbuxhetit të dërguar nga DPD për vitin 2018 dhe vitin 2019 në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, rezultoi se ai nuk është shoqëruar me një analizë të objektivave për vitin si dhe me produktet për realizimin e objektivave. Gjithashtu në kërkesat për buxhet, nuk rezultojnë të plotësuar formularët për kërkesat shtesë mbi tavanet limit të miratuara dhe argumentimin e domosdoshmërisë së këtyre fondeve, me qëllim alokimin e tyre nga Ministria e Financave sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, Aneksi 1, UMF nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 14 – 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e DPD-së, të marrë masa që gjatë hartimit të PBA-së, të plotësohen formularët për fondet jashtë tavaneve të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave referuar nevojave për investime, mallra e shërbime mbi këto tavane si kusht për mundësinë e çeljeve të fondeve për plotësimin e këtyre nevojave si dhe të merren masa për një planifikim e menaxhim të koordinuar të buxheteve vjetore me ato të PBA. PBA dhe raportet e monitorimit të shoqërohen me analiza të treguesve si dhe të objektivave e produkteve përkatëse.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme Detare, për vitin 2018 ka realizuar 14 procedura prokurimi me vlerë totale të prokuruar 8,891,984 lekë me TVSH nga të cilat 4 procedura kanë objekte që i përkasin një grupi mallrash të ngjashëm dhe kapin vlerën e 2,640,900 lekë pa TVSH. Njësoj ka vepruar DPD edhe për vitin 2019 ku nga 13 procedura prokurimi të realizuara me vlerë totale të prokuruar 7,062,872 lekë me TVSH, 4 procedura kanë objekte që i përkasin një grupi mallrash të ngjashëm me vlerë totale të prokuruar prej 2,325,710 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 28, pika 2 dhe nenin 40, pika 1 e Ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006 i ndryshuar “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 1 dhe pika 8 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikën 3, të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, i ndryshuar “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 17 – 20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat që në të ardhmen të mos copëzohen fondet për grup mallrash të ngjashëm duke shmangur në këtë mënyrë kryerjen e procedurave normale të prokurimit në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë kryer me parregullsi, kjo për sa i përket justifikimit të fillimit të disa prej procedurave të prokurimit. Konkretisht u konstatua mungesa e argumentimit dhe dokumentimit të nevojës për mallra, shërbime apo riparime. Për rastet e kryerjes së procedurave për blerje mallrash, DPD nuk ka dokumentuar nevojën përmes verifikimeve paraprake të gjendjes së këtyre mallrave në magazinë apo duke ju referuar kërkesave për blerje mallrash nga njësitë e vartësisë. E njëjta situatë paraqitet edhe për procedurat e prokurimit për kryerjen e riparimeve apo shërbimeve për të cilat nuk kanë argumentim lidhur me defektet e ndodhura përpara se të kërkohej prokurimi i riparimit të pajisjeve apo zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara sipas zërave përkatës për riparim ose shërbim. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 40, pika 3, paragrafi dytë dhe neni 59, fjalia e fundit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 17 – 20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat për justifikimin/argumentimin paraprak me dokumentacion vërtetues të nevojën së kryerjes së shërbimit/riparimit apo të blerjes së mallrave përpara fillimit të kryerjes së procedurave të prokurimit për blerje mallrash apo riparime pajisjesh, kjo me qëllim shmangien e kryerjes së shpenzimeve për mallra apo shërbime të pa nevojshme për institucionin.

Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2018-2019, rezultoi se informacionet sqaruese të tyre (bilancet), nuk kanë shënimet shpjeguese të plota me zberthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo problemet që kanë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. DPD nuk disponon dokument që të vërtetojë se aktivet e qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në llogarinë 212 “Ndërtime dhe rikonstrukcione”, janë në pronësi apo në administrim të kësaj Drejtorie. Nga DPD janë kryer plan rilevimet për godinat e kapitenerive të porteve Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë. Planet e rilevimit janë dokumentet kryesorë që japin informacion mbi statusin e pronësisë së objekteve/godinave që institucionet kanë në përdorim, në pronësi apo administrim. Mos

marrja e masave për regjistrimin e inventarit në përdorim nga DPD është tregues i menaxhimit jo të mirë të aseteve të njësisë publike dhe bie ndesh me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 1, pika 19.

-Pasqyrat financiare dhe Pasqyrat e realizimit të buxhetit për të dy vitet kanë mospërputhje të faktit të realizimit të buxhetit me faktin e pasqyruar në pasqyrat e kontabilitetit. Këto mospërputhje, kanë ardhur si rezultat i mos kuadrimin të llogarive analitike me llogaritë sintetike (të gjendjeve) që pasqyrohen në pasqyrat financiare në fund të vitit siç kërkohet në Udhëzimin nr. 8 të MFE “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 8.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 23 – 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, nëpërmjet Drejtorisë të Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Financës, të marrë masa për:

- Sistemimin e diferencave të fondeve të veta, të cilat duhet të jenë të barabarta me pasqyrimin e tyre në bilanc.

- Saktësimin e detyrimeve afatshkurtra si detyrime, likuidimi i të cilave duhet të bëhet brenda një viti ose një cikli operativ (ekonomik) duke përdorur aktivet e veta afatshkurtra ose duke krijuar detyrime të tjera afatshkurtra.

- Kryerjen e veprimeve përkatëse rregulluese kontabël në llogaritë kreditore për detyrimet ndaj furnitorëve, ndaj detyrimeve tatimore e të tjera në vijimësi dhe të bëhet pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2020.

- Regjistrimin e aseteve në pronësi të DPD-së dhe pasqyrimin e tyre të drejtë në pasqyrat financiare

Menjëherë e në vijimësi

5.2 Rekomandimi: DPD Durrës, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Financës, të marrë masa për kryerjen e kuadrimeve të nevojshme me qëllim që raportimet faktike të buxhetit të rakordojnë me raportimet në pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës nuk ka përcaktuar Grupin e Menaxhimit të Risqeve dhe planin e veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrim i neneve 8, pika 8/a dhe pika 10, e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe nuk është përcaktuar koordinatori i risqeve në fushat e këtij institucioni. Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt negativ për përmbushjen e objektivave, rezultoi se nuk janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontrolleve ekzistuese dhe nevojave për kontrolle të reja, por nuk janë hartuar për çdo zotërues e sektor, sipas përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 të Menaxhimit të Riskut, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Institucioni të rishikojë dhe përditësojë çdo vit Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioritetëve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata që ky institucion ka.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet 29 – 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare, Nëpunësi Autorizues të marrë masa që të përcaktohet Grupi për Menaxhimin e Riskut dhe të miratojë koordinatorin e riskut të institucionit, konform përcaktimeve të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Institucioni të rishikojë dhe përditësojë çdo vit Grupin për Menaxhimin e Riskut dhe koordinatorin e riskut.

Menjëherë

6.2 Rekomandimi: DPD Durrës, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, të marrë masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Ministrinë e linjës për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve për arritjen e objektivave të vendosura

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Inventarët e mjeteve mbahen në mënyrë dokumentare/shkresore nga Drejtoria e Sigurisë Detare, Administrimit dhe Kontrollit Shtetëror (*Spektori i regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare*) dhe nuk ka një regjistër elektronik. Dixhitalizimi i të dhënave, do të bënte të mundur informimin në kohë dhe kryerjen e detyrave me efektivitet nga punonjësit e institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 12, faqe 33 – 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare, Nëpunësi Autorizues, të informojë MIE mbi situatën e inventarizimit të mjeteve lundruese dhe në bashkëpunim me MIE të ndërmarrin hapat për propozimin e realizimit të një projekti të dixhitalizimit të inventarit të mjeteve lundruese dhe publikimin e tyre në mënyrë elektronike për stafin e institucionit.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj për riparimin, mirëmbajtjen apo shërbime të sistemeve IT, vlerën prej **2,674,420 lekë** ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Titullari i AK por dhe Komisioni i blerjeve të vogla, si dhe Drejtoria e shërbimeve Mbështetëse dhe Sektorin Juridik, për mirëmbajtjen apo shërbimin e sistemeve IT të institucionit, duhej ti referoheshin VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “*Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*” e ndryshuar dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 “*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018*” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e DPD. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 2,674,420 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 17 – 20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare, të marrë masat e nevojshme, për të bashkëpunuar me AKSHI-n, referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke eliminuar kostot e panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve IT.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës për kontratën nr. 6811, datë 03.12.2018, të lidhur midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik òR.C.ò SHPK (me përfitues DPD) dhe objekt “*Vendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi*”, ka likuiduar vlerën prej 68,933,400 lekë me TVSH. Për mirëmbajtjen e sistemit apo riparimin e tij, DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj 1,267,200 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhej të ishin përballuar nga AKSHI. Mos rakordimi i strukturave të institucionit të DPD-së, ka sjellë si rezultat rritjen e shpenzimeve të panevojshme për buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 1,267,200 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 20 – 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, të marrë masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël si dhe eliminimin e kostove të panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.

Në vijimësi

2.2 Rekomandimi: DPD, në bashkëpunim me AKSHI-n dhe MIE, të marrin masa për mbulimin e shpenzimeve për zërin òF.V. Raportimi Automatik i Pozicionit LRITò dhe garantimin nga AKSHI të funksionimit të sistemit me kontrata shumë vjeçare të cilat të jenë njësoj në kohë si për mirëmbajtjen e sistemit por edhe të raportimit automatik, për të siguruar funksionimin e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimi.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 òKodi i Punësò, i ndryshuar, kontratës kolektive dhe kontratave individuale të punës neni 15, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, që në varësi të kompetencave ligjore të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje”, për:

1.Z. B.Ç., në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla

2.Znj. B.Ç., në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla

3.Znj. M.K., në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, *për:*

Copëzimin e fondeve publike në kryerjen e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, për të njëjtët artikuj apo grup artikujsh, si dhe për kryerjen e procedurave të prokurimit për sistemet IT, procedura të cilat duhet të kryheshin nga AKSHI. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 2,674,420 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efijensës, ekonomicitetit dhe efektivitetit.

4.Znj. F.I., Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse, dhe

5.Z. K.B., Specialisti i Sektorit Juridik, *për:* kontratën nr. 6811, datë 03.12.2018, të lidhur midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik òR.C.ò SHPK (me përfitues DPD) dhe objekt òVendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimiò, ku janë likuiduar vlera prej 68,933,400 lekë me TVSH. Për mirëmbajtjen e sistemit apo riparimin e tij, DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj 1,267,200 lekë, shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijensës dhe efektivitetit të fondeve publike, për sa këto shpenzime duhet të ishin përballuar nga AKSHI.

C.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte *“Vërejtje” për:*

1. Z. H.H., në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, *për:*

-Copëzimin e fondeve publike në kryerjen e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, për të njëjtët artikuj apo grup artikujsh, si dhe për kryerjen e procedurave të prokurimit për sistemet IT, procedura të cilat duhet të kryheshin nga AKSHI. Vlera e shpenzuar për riparime/mirëmbajtje dhe shërbime IT prej 2,674,420 lekë, përbën një shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit.

-Kontratën nr. 6811, datë 03.12.2018, të lidhur midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik òR.C.ò SHPK (me përfitues DPD) dhe objekt òVendosja e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit të anijeve me rreze të gjatë veprimiò, ka likuiduar vlerën prej 68,933,400 lekë me TVSH. Për mirëmbajtjen e sistemit apo riparimin e tij, DPD ka shpenzuar nga buxheti i saj 1,267,200 lekë, shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike, për sa këto shpenzime duhet të ishin përballuar nga AKSHI.

V. ANEKSE

3. Mbi planifikimin, hartimin dhe realizimin e planit vjetor financiar dhe të biznesit si dhe raportimi i tyre.

Në tabelat 1, 2 më poshtë paraqiten treguesit e PBA për vitin 2018:

Tab. 1 *ne 000 /leke*

Llogaria	Pershkrimi	Tavani		Kerkesa shtese		Diferenca		Fakti viti 2018
		Faza I	Faza II	Faza I	Faza II	Tavani	Shtesa	
600-601	Paga, sigurime shoqerore	86,000	81,000	0	0	-5,000	0	73,594
602-606	Korrente te tjera	22,330	22,330	0	0	0	0	17,605
230-232	Kapitale te brendeshme	39,000	35,560	0	0	-3,440	0	35,538
	Totali	147,330	138,890	0	0	-8,440	0	126,737

Burimi : DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Tab. 2 *në 000 /leke*

PBA	paga, sigurime shoqerore	Korrente te tjera	Kapitale te brendeshme	Gjithsej
PBA Faza I	86,000	22,330	39,000	147,330
PBA Faza II	81,000	22,330	35,560	138,890
Buxheti fillestar	86,000	22,330	39,000	147,330

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

.Ndërsa në tabelat 3, 4 mëposhtë paraqiten treguesit e PBA për vitin 2019:

Tab. 3 *ne 000 /leke*

Llogaria	Pershkrimi	Tavani		Kerkesa shtese		Diferenca		Fakti viti 2019
		Faza I	Faza II	Faza I	Faza II	Tavani	Shtesa	
600-601	Paga, sigurime shoqerore	86,000	86,000	0	0	0	0	81,744
602-606	Korrente te tjera	13,030	13,030	0	0	0	0	11,835
230-232	Kapitale te brendeshme	44,374	44,374	0	0	0	0	44,373
	Totali	143,404	143,404	0	0	0	0	137,952

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Tab. 4 *ne 000 /leke*

PBA	Paga sigurime shoqerore	Korrente te tjera	Kapitale te brendeshme	Gjithsej
PBA Faza I	86,000	13,030	44,374	143,404
PBA Faza II	86,000	13,030	44,374	143,404
Buxheti fillestar	86,000	13,030	44,374	143,404

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela e treguesve per PBA viti 2020 paraqitet të DPD në tab. 5, 6

Tab. 5 *ne 000 /leke*

Llogaria	Pershkrimi	Tavani		Kerkesa shtese		Diferenca		Fakti viti 2020
		Faza I	Faza II	Faza I	Faza II	Tavani	Shtesa	
600-601	Paga, sigurime shoqerore	92,672	92,672	0	0	0	0	0
602-606	Korrente te tjera	17,328	17,328	0	0	0	0	0
230-232	Kapitale te brendeshme	495,000	495,000	0	0	0	0	0
	Totali	605,000	605,000	0	0	0	0	0

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Tab. 6 *ne 000 /leke*

PBA	paga, sigurime shoqerore	Korrente te tjera	Kapitale te brendeshme	Gjithesej
PBA Faza I	92,672	17,328	495,000	0
PBA Faza II	92,672	17,328	495,000	0
Buxheti fillestar	92,672	17,328	495,000	0

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Me shkresën nr.4222 prot., datë 29.12.2017 (protokolluar në DPD me nr. 03 prot., datë 03.01.2018) dhe me shkresën nr. 03/1 prot., datë 08.01.2018 ardhur nga MTI është dërguar limiti mujor i planit të buxhetit për shpenzimet korrente, si dhe me shkresën nr. 57/3 prot.,

datë 09.02.2019 nga MTI është dërguar miratimi i detajimit pjesor të planit të buxhetit 2018-2020.

Projektbuxhetit Afatmesëm 2019-2021, nuk është shoqëruar me Deklaratën e Politikës së Programit për Transportin Detarë, ku DPD Durrës është pjesë e tij.

Referuar formularëve të plotësuar nuk rezulton që nga DPD të ketë bërë kërkesa për investime prioritare.

Me shkresën e Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjitikës nr.4222 prot. date 29.12.2017 është bërë çelja e buxhetit për vitin 2018 (protokolluar në DPD me nr. 03 prot. date 03.01.2018, ndërsa çelja e buxhetit për vitin 2019 me shkresën nr. 15503/4/ datë 17.01.2019 të Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjitikës, protokolluar në DPD me Nr.shkresë 25/2 date 18.01.2019 për shpenzimet korente, dhe me shkresën me Nr. 761/4 datë 22.02.2019 protokolluar në DPD me nr.shkresë 623/3/2 date 25.02.2019 për shpenzimet kapitale.

Tabela e realizimit të buxhetit gjithsejt në DPDetare, për vitet 2018, 2019, 2020

Tab. 7 000/lekë

Nr.	Periudha	Plani fillestar	Plani përfundimtar	Fakti	%
1.	Viti 2018	147,330	138,890	126,737	91.2
2.	Viti 2019	143,404	143,404	137,953	96.2
3.	Viti 2020 (3 muj. I-rë)	53,671	53,671	20,840	38.8

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Sa më sipër niveli i realizimit të shpenzimeve në total institucioni paraqitet për v. 2018: 91.2 %, tregues që është përmirësuar në v. 2019: 96.2 % dhe për v. 2020 për 3 mujorin e I-rë është realizuar vetë në masën 38.8 %.

Për vitin 2018 realizimi i treguesve buxhetorë sipas zërave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tab. 8 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar	Plani përfundimtar	Fakti	%
1.	Paga (600)	72,500	67,500	63,199	93.6
2.	Sigurime Shoqërore (601)	13,500	13,500	10,395	77
3.	Mallra Shërbime (602)	22,260	22,260	17,535	78.7
5.	Transferta për buxhetet familjare dhe individët (606)	70	70	70	100
6.	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231) Ndertimi sistemit LRIT	28,000	24,560	24,560	100
7	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231) Rikonstruksioni Godines Kapiteneria Shëngjin	11,000	11,000	10,978	99.8
	Totali	147,330	138,890	126,737	91.2

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Siç rezulton nga tab. 8, janë realizuar zërat e investimeve: për vitin 2018 janë realizuar investimet në zërat përkatës të tyre (Ndertimi sistemit LRIT si dhe Rikonstruksioni Godines Kapiteneria Shëngjin) dhe realizimi i tyre paraqitet në shumën 99 % . Diferenca e përealizuar rezulton kryesisht nga mos realizimi i zërit mirëmbajtje sistemi IT të diçitalizuar dhe ku për këtë zë nga DPD nuk duhej të çelej fondi gjatë vitit 2019 por në vitet e mëpasshme kur ky shërbim do të kryhej. Ky planifikim i gabuar për fondin e vitit 2019 ka çuar në mosrealizimin e pjesës së fondit për mirëmbajtje dhe vështirësi në likuidimin e këtij shërbimi në vitet e mëpasme, pasi kontrata rezulton e përealizuar dhe nga DPD nuk ka fonde të çelura në vitin 2020 për këtë shërbim të kontraktuar dhe të pa realizuar në vitin 2019, veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Pa realizim paraqiten treguesit e pagave, sigurimeve shoqërore të cilat vijnë si rrjedhojë e mosrealizimit të pagave dhe zëri i mallrave e shërbimeve.

Ndërsa për vitin 2019 realizimi i treguesve buxhetorë I detajuar sipas zërave paraqitet në tabelën si më poshtë:

Tab. 9

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar	Plani përfundimtar	Fakti	%
1.	Paga (600)	72,500	72,500	70,106	96.7
2.	Sigurime Shoqërore (601)	13,500	13,500	11,638	86.2
3.	Mallra Shërbime (602)	13,000	13,000	11,835	91
5.	Transferta për buxhetet familjare dhe individet (606)	30	30	–	–
6.	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231) Ndertimi sistemit LRIT	44,374	44,374	44,374	100
	Totali	143,404	143,404	137,953	96.2

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Siç shifet më sipër nga tabela shpenzimet për paga, sigurime shoqërore janë në rritje 2019/2018 prej rreth 11%, dhe investime 25 %, ndërsa për zërat mallra e shërbime janë shumë në nivelin e realizimit të vitet. paraardhës, përkatësisht - 30%.

Vlen të theksohet se përqindjen më të lartë të fondeve në institucion e përbëjnë pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 66 % për v. 2018 dhe 59 % për v. 2019 ku dhe llogaritja e tyre është konkrete, në bazë të numrit të punonjësve të miratuar si dhe në bazë të kategorive të pagave për çdo pozicion pune, kështu efektet e një menaxhimi efektiv të fondeve shikohen kryesisht në menaxhimin e fondeve për shpenzime operative dhe investime. Duke qenë se DPD Durrës nuk ka fonde të konsiderueshme për të menaxhuar, ka rezultuar se këto fonde janë përdorur kryesisht referuar planifikimeve përkatëse.

Tabela e treguesve buxhetore sipas zërave për vitin 2020:

Tab. 10 në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar	Plani përfundimtar	Fakti 31.03.2020	%
1.	Paga (600)	19,861	19,861	17,181	86.5
2.	Sigurime Shoqërore (601)	3,390	3,390	2,846	84
3.	Mallra Shërbime (602)	4,256	4,256	813	19.1
5.	Transferta për buxhetet familjare dhe individet (606)	164	164	–	–
6.	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)	26,000	26,000	–	–
	Totali	53,671	53,671	20,840	38.8

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Viti 2020 nuk ka të çelura fonde për investime në momentin e auditimit dhe karakteristike për vitin 2020 është rritja e shpenzimeve për paga sigurime shoqërore si rezultat i ndryshimeve të numrit të punonjësve.

5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve në lekë e valutë. Kryerja e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.).

-Lidhur me magazinën, u konstatua se në të gjitha rastet e furnizimit të mallrave, janë mbajtur fletë-hyrjet dhe fletë-daljet për njësitë e vartësisë.

-Nga auditimi me zgjedhje lidhur me pagat e punonjësve të DPD-së, nuk u konstatuan mangësi përsa i përket llogaritjes së pagës sipas kategorive. Të gjithë punonjësit me status nëpunësi, paguhen në përputhje me VKM nr. 187, datë 08.03.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë e ndryshuar.

-Lidhur me shpenzimet e karburantit, u konstatua se janë ngritur komisionet e përcaktimit të normativave të mjeteve dhe përkatësisht:

-Me shkresën nr. 418/16 prot., datë 15.12.2015 “Mbi miratimin e normativës së konsumit të karburantit të motoskafeve të Kapitenerive të Porteve Durrës dhe Shëngjin”. Procesverbali i mbajtur me shkresën nr. 418/17 prot., datë 15.12.2015 nga komisioni me përbërje F.I., G.S. dhe T.H., ka përcaktuar pas testeve të kryera se motoskafi i Kapitenerisë Durrës konsumon 60 litra në orë naftë dhe motoskafi i Kapitenerisë Shëngjin 40 litra në orë benzinë.

-Me shkresën nr. 11/4 prot., datë 21.02.2018 “Mbi miratimin e normativës së konsumit të karburantit të automjetit tip Mercedes Benz ML350 me targë A...R (i marrë në përdorim nga DPD)”. Procesverbali i mbajtur me shkresën nr. 11/5 prot., datë 23.02.2018 nga komisioni me përbërje K.B., B.H. dhe V.LL., ka përcaktuar pas testeve të kryera se automjeti i mësipërm, konsumon 10.5 litra naftë për 100 km.

-Me shkresën nr. 2260/1 prot., datë 28.10.2019 “Mbi miratimin e normativës së konsumit të karburantit të automjetit tip Mercedes Benz E 220 me targë A...D. (i marrë në përdorim nga DPD pas heqjes nga përdorimi të automjetit tip Mercedes Benz ML350 me targë A...R)”. Procesverbali i mbajtur me shkresën nr. 2260/2 prot., datë 28.10.2019 nga komisioni me përbërje K.B., B.H. dhe D.B., ka përcaktuar pas testeve të kryera se automjeti i mësipërm, konsumon 11.5 litra naftë për 100 km.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me konsumin e karburantit, u konstatua se DPD ka konsumuar për vitin 2018 për përdorimin e motoskaftit të Kapitenerisë së Portit Durrës, 11171 litra naftë, për përdorimin e automjetit tip Mercedes Benz ML 350, 4520 litra naftë dhe për përdorimin e motoskaftit të Kapitenerisë së Portit Shëngjin deri në datën 17.04.2019 (pas kësaj date ky motoskaft është transferuar tek Kapiteneria e Portit Sarandë), 150 litra benzinë. Në total për vitin 2018, DPD ka konsumuar 15691 litra naftë dhe 150 litra benzinë.

Për vitin 2019, DPD ka konsumuar për përdorimin e motoskaftit të Kapitenerisë së Portit Durrës, 13500 litra naftë, për përdorimin e automjetit tip Mercedes Benz ML 350, 2685 litra naftë deri në datën 11.05.2019 dhe 957 litra naftë nga data 29.10.2019 deri në datën 31.12.2019, me automjetin Mercedes Benz E220 (ML350 u zëvendësua me E220). Për përdorimin e motoskaftit të Kapitenerisë së Portit Sarandë nga data 17.04.2019 deri në datën 31.12.2019, 3304 litra benzinë. Në total për vitin 2019, DPD ka konsumuar 17142 litra naftë dhe 3304 litra benzinë.

Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit shoqërues i cili vërteton konsumin e karburantit për çdo vit, nuk u konstatuan mangësi.

7. Mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilanceve nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe dërgimi e miratimi i tyre në organet e varësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Pasqyrat financiare të Aktivit dhe Pasivit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2018 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

AKTIVI	Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2018 (ne bilanc)	Gjendje në fund të vitit 2018 (ne programin e kontabilitetit)	Diferenca gjendje bilanci me gjendje kontabilitetit viti 2018
A.	<i>Aktive të qëndrueshme</i>	279,187,246	279,187,246	0
20, 230	Aktive të patrupëzuara	23,133,600	23,133,600	0
21,23,24,28	Aktive të trupëzuara	211,193,636	211,193,636	0
231		44,860,010	44,860,010	0
B	<i>Aktive qarkulluese</i>	30,820,738.88	33,428,567.88	2,607,829
31,32	Gjendja e inventarit	19,801,954	19,801,954	0
411-418437,438, 4342, 468.	Kërkesa arkëtimi mbi debitorë	7,025,098	7,020,827	+4,271
50.59	Llogaritë financiare	3,903,007.88	6,515,107.88	2,612,100 (204442)
C	<i>Llogari të tjera aktive</i>	90,679	90,679	0
	Rezultati i ushtrimit (Saldo debitore)	-		
Totali i Aktivit		310,007,984.88	312,615,813.88	2,607,829

PASIVI	Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2018 (ne bilanc)	Gjendje në fund të vitit 2018(ne programin e kontabilitetit)	Diferenca gjendje bilanci me gjendje kontabilitetit viti 2018
A	Fondet e veta	293,010,450	293,286,294.18	276,702
10-15	Fonde të veta	293,010,450	293,286,294.18	275,844
B	Detyrime	16,463,530.88	16,464,388	857
41-46	Detyrime afatshkurtër	16,463,530.88	16,464,388	857
C (47-48)	Llogari të tjera	534,004	534,004	-
85	Rezultati i ushtrimit (Saldo kreditore)	-	-	-
Totali i Pasivit		310,007,984.88	309,731,282.88	276,702

Burimi : DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Pasqyrat financiare të Aktivit dhe Pasivit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2019:

AKTIVI	Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2019 (ne bilanc)	Gjendje në fund të vitit 2019(ne programin e kontabilitetit)	Diferenca gjendje bilanci me gjendje kontabilitetit viti 2019
A.	Aktive të qëndrueshme	284,564,999	284,564,999	0
20, 230	Aktive të trupëzuara	19,663,560	19,663,560	0
21,23,24,28	Aktive të trupëzuara	264,901,439	264,901,439	0
B	Aktive qarkulluese	28,328,266.11	36,187,537	7,859,271
31,32	Gjendja e inventarit	16,121,150	16,120,107	1,043
411-418437,438, 4342, 468.	Kërkesa arkëtimi mbi debitorë	7,048,663	6,903,963	144,700
50,59	Llogaritë financiare	5,060,310.11	13,163,466.65	8,103,167
C	Llogari të tjera aktive	98,143	0	98,143
	Rezultati i ushtrimit (Saldo debitorë)	-		
Totali i Aktivit		312,893,265.11	320,752,536	7,859,271
PASIVI	Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2019 (ne bilanc)	Gjendje në fund të vitit 2019(ne programin e kontabilitetit)	Diferenca gjendje bilanci me gjendje kontabilitetit viti 2019
A	Fondet e veta	300,686,149	8,549,631	292,136,518
10-15	Fonde të veta	300,686,149	8,549,631	292,136,518
B	Detyrime	12,207,116	11,592,082	615,030
41-46	Detyrime afatshkurtër	11,790,966.11	11,592,082	198,880
C (47-48)	Llogari të tjera	416,150	0	416,150
85	Rezultati i ushtrimit (Saldo kreditore)	-		
Totali i Pasivit		312,893,265.11	20,141,713	292,751,548

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Rakordimi i buxhetit faktik me te dhenat e kontabilitetit per vitin 2018 (000/leke)

Llogaria	Pershkrimi	Fakti sipas buxhetit	Fakti sipas kontabilitetit	Dif.
600	Paga, sigurime shoqerore	63,199	63,199	-
601	Sigurime shoqerore	10,395	10,395	-
602	Mallra sherbime	17,535	17,535	-
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individet	70	70	-
231	Shpenzime kapitale të trup. Ndertimi sistemit LRIT	24,560	23,881	679
231	Shpenzime kapitale të trup. Rikonstruksioni Godines Kapiteneria Shengjin	10,978	20,978	10,000
Total		126,737	136,058	10,679

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Rakordimi i buxhetit faktik me te dhenat e kontabilitetit per vitin 2019 (000/leke)

Llogaria	Pershkrimi	Fakti sipas buxhetit	Fakti sipas kontabilitetit	Diferenca
600	Paga, sigurime shoqerore	70,106	70,106	-
601	Sigurime shoqerore	11,638	11,638	-
602	Mallra sherbime	11,835	11,835	-
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individet			-
231	Shpenzime kapitale të trupëzuara Ndertimi sistemit LRIT	44,374	0	44,374
	Total	137,953	93,579	44,374

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

1.3 Detyrimet debitore dhe kreditore

Për vitin 2018 këto detyrime paraqiten në tabelën tek anekset.

Në lekë

Llogari te arkëtueshme	Gjendja në fund te vitit 2018	Analiza e llogarisë
412	5,129	Detyrimi i DPD. ndaj klientit .Derdhur paradhënie nga klientet per taksen portuale per vitin 2018.(41.25 euro *124.33 kursi i BSH date 31.12.2018=5,129 leke)
4342	6,042,552	Sa detyrimi i mbartur për likuidim ne 2019 përbehet nga:paga 4,171,611,tatim 432,519,sig shoq 1,262,248,sig shëndetësor 176,174, te muajit dhjetor 2018
437	847,846	Detyrimi i klienteve ndaj DPD.Sa vlera e t.portuale derdhur paradhënie nga agjencitë (6,819.3 eur0*124.33 lek kursi I BSH dt 31.12.2018)
468	134,700	Debitore për gjoba :A.J. 104700; A.O. 15,000,Anija T. 15,000
Shuma	7,030,227	

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Në lekë

Llogari te arketushme	Gjendja në fund te vitit 2019	Analiza e llogarisë
412	83,000	Derdhur paradhënie nga klientet per taksen portuale per vitin 2019.(668 euro *124.33 kursi i BSH date 31.12.2018=83.000 leke)
4342	6,551,388	Sa detyrimi I mbartur për likuidim ne 2019 përbehet nga:paga 4,524,243,tatim 466,174,,sig shoq 1,369,990,sig shëndetësor 190,981, te muajit dhjetor 2019
437	362,575	Sa vlera e t.portuale derdhur paradhënie nga agjencitë (2,916 euro*124.23 lek kursi I BSH dt 31.12.2016)
468	134,700	Debitore për gjoba :A.J. 104700; A.O. 15,000,Anija T. 15,000
Shuma	7,131,663	

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Pasqyrat financiare të Aktivit dhe Pasivit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2018 paraqiten në tabelën e mëposhtme: Tab. 1

AKTIVI	Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2018 (ne bilane)	Gjendje në fund të vitit 2018(ne programin e kontabilitetit)	Diferenca gjendje bilanci me gjendje kontabilitetit viti 2018
A.	Aktive të qëndrueshme	279,187,246	279,187,246	0
20, 230	Aktive të patrupëzuara	23,133,600	23,133,600	0
21,23,24,28	Aktive të trupëzuara	211,193,636	211,193,636	0
231		44,860,010	44,860,010	0
B	Aktive qarkulluese	30,820,738.88	33,428,567.88	2,607,829
31,32	Gjendja e inventarit	19,801,954	19,801,954	0
411-418437,438, 4342, 468.	Kërkesa arkëtimi mbi debitorë	7,025,098	7,020,827	+4,271
50.59	Llogaritë financiare	3,903,007.88	6,515,107.88	2,612,100 (204442)
C	Llogari të tjera aktive	90,679	90,679	0
	Rezultati i ushtrimit (Saldo debitore)	-		
Totali i Aktivit		310,007,984.88	312,615,813.88	2,607,829
		Gjendje në fund të vitit	Gjendje në fund	Diferenca

PASIVI	Llogaritë	2018 (ne bilanc)	të vitit 2018(ne programin e kontabilitetit)	gjendje bilanci me gjendje kontabilitetit viti 2018
A	Fondet e veta	293,010,450	293,286,294.18	276,702
10-15	Fonde të veta	293,010,450	293,286,294.18	275,844
B	Detyrime	16,463,530.88	16,464,388	857
41-46	Detyrime afatshkurtër	16,463,530.88	16,464,388	857
C (47-48)	Llogari të tjera	534,004	534,004	-
85	Rezultati i ushtrimit (Saldo kreditore)	-	-	-
Totali i Pasivit		310,007,984.88	309,731,282.88	276,702

Burimi : DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Nga analiza e llogarive të bilancite vitit 2018 të DPD, rezulton;

Aktivi i bilancit i institucionit, në fund të vitit 2018 është 310,007,984.88 lekë I barabarte me pasivet e bilancit 310,007,984.88 lekë. Te dhenat e aktivitetit të bilancit për vitin 2018 nuk kuadrojne me llogaritë e gjendjeve të regjistruara në programin e kontabilitetit, si rrjedhim Aktivi i bilancit rezulton në shumën **310,007,984.88 leke, Aktivi i programit të kontabilitetit rezulton në shumën 312,615,813.88 leke**, diferenca në shumën **2,607,829 lekë**. Shuma e aktivitetit të bilancit pasqyron aktivitetet e qëndrueshme, aktivitetet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit, që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Grupi i auditimit konstatoi se diferenca **2,607,829 lekë** është si rezultat se në zerin aktive qarkulluese në zërat analitik të tij si : *llogaria ökerkesa arketimi mbi debitoret” diferenca në shumën 4,271 lekë është diferenca e detyrimeve të DPD për taksën portuale të kreditoreve dmth të klienteve të cilët pasqyrohen në janar të vitit që vjen.(në janarin e vitit 2019).*

Në zerin llogari financiare në bilanc rezulton shuma 3,903,007.88 leke, ndërsa në programin financiar shuma 6,515,107.88 leke, diferenca 2,616,371 lekë përbehet nga llogaritë mjete në ruajtje për pasaportë lundrimi dhe mjete në ruajtje për taken portuale.

Në programin e kontabilitetit këto dy llogari rezultojnë me shume 2,816,542 lekë . Kjo shume përbehet nga (mjete në ruajtje për pasaportë lundrimi me shume 1,943,500 lekë , dhe llogaria mjete në ruajtje për taken portuale me shume 873,042.88 lek), nga ku rezulton një diferencë me shume lekë 204442 lekë e cila është shume që transferohet në janarin e vitit që vjen. (në janarin e vitit 2019).

Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe dega e Thesarit Durrës kanë rakorduar për ngurtesimin e fondit 5% garanci për difekte në shumën 3,698,565 leke; llogaria mjete në ruajtje me taksën portuale në shumën 60,691.95 lekë dhe tarife për pasaportë lundrimi në shumën 143.750 lekë gjithësej 204,441.95 leke, të cilat trashëgohen për vitin 2019.

Në zerin aktive afatgjata materiale të bilancit nuk ka diferenca nga programi i kontabilitetit financiar. Ato rezultojnë në shumën 279,187,246 lekë.

Kjo shume përbehet shuma 23,881,724 lekë për Rikonstruksionin e Kapitenerisë Sarandë (llogaria 23112101) dhe nga shuma 20,978,286 lekë për Rikonstruksionin e Kapitenerisë Shëngjin (llogaria 2312101),

Nga analiza e llogarive konstatohet se, Llogaria 31 öMaterialeö, në vitin 2017 paraqitet me vlerën 16,050,569 lekë, në fund të vitit 2018 paraqitet me vlerën 19,801,954 lekë. Ka një rritje të inventarëve për blerje të kryera gjatë vitit, si materiale dhe kancelari, tonerë për printera, letër format, dosje pune, etj.

Llogaria 212, öNdërtime e konstruksioneö paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën prej 137,283,459 lekë.

Gjatë vitit 2018 janë shtuar aktive qarkulluese të patrupëzuara në shumën 23,133,600 lekë që korrespondon me investimin e kryer gjatë vitit 2018 östudimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit për vendosjen e një sistemi të monitorimit dhe informacioni të trafikut detarö.

Shuma e investimit të Aktiveve Afatgjata Materiale është në shumën 44,860,010 lekë - *Ndërtimi i sistemit LRIT në shumën 28,000 lekë dhe - Rikonstruksioni i Godines Kapiteneria Shengjin në shumën 11,000 lekë.* (të dhëna marrë nga pasqyra e realizimit të buxhetit).

Ky investim deri në fund të vitit 2018 ka qenë në proces në llogarinë 231, konkretisht në shumën 33,881,724 lekë nga viti 2017, dhe ka vazhduar në vitin 2018 duke ju rritur vlerën me 10,978,286 lekë. Në dorëzim ky investim është marrë në prill të vitit 2019, duke u regjistruar nga aktive në proces në zerin Aktive Afatgjata Materiale.

Gjithashtu gjatë vitit 2018 ka ndryshuar në ulje dhe llogaria 215 mjete transporti, si rezultat i rritjes së vlerës së amortizimit të tyre në vlerën 80,151,060 lekë, kjo kon në ndryshimin e vlerës neto të mjeteve të transportit në 27,381,100 lekë nga kostojat historike 107,532,160 lekë. Shifrat e vendosura në pasqyrën e aktivitetit të bilancit për AQT dhe AQ të patrupëzuara rakordojnë me formatin nr. 7/a të pasqyrave financiare të Gjendja dhe ndryshimet e AQ.

Pasivi i bilancit për vitin 2018, është i njëjtë me aktivin, në shumën **310,007,984.88** lekë ku fondet e veta të DPD janë në shumën 293,010,450 lekë, detyrime afatshkurtra janë 16,463,530.88 lekë.

Ne llogarite e gjendjeve të programit sintetik të kontabilitetit të institucionit fondet e veta të DPD janë në shumën 293,286,294.18 lekë, detyrimet afatshkurtra janë në vlerën 16,463,530.88 lekë; nga auditimi rezulton se ka një moskudrim të fondeve të veta të paraqitura në bilanc në shumën 276,702 lekë me shumën e fondeve të veta të paraqitura në programin financiar të institucionit.

Drejtoria e Përgjithshme Detare ka në pasivin e vet për vitin 2018 zërin llogari të pagueshme e cila është llogari detyrimesh afatshkurtra. Në këtë llogari futen detyrimet e pagave, sigurimeve, tatimet mbi të ardhurat personale (TAP), dhe shumat e tyre pasqyrojnë detyrimet vetëm për muajt dhjetor. Pagesa e tyre bëhet në janarin e vitit që vjen dmt, 2019. Shuma në llogarinë 42 Personeli dhe llogari të lidhur me to në vlerën 4,171,611 lekë, Llog. 435 dhe 436 Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore përkatësisht në vlerat 1,262,248 lekë dhe 176,174 lekë, kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe TAP (tatim mbi të ardhurat personale) në shumën 432,519 lekë. Këto shuma që përfaqësojnë pagat e muajit Dhjetor 2018, të cilat janë likuiduar në janar 2019, me fondet buxhetore të planifikuara për këtë vit buxhetor.

Nga grupi i auditimit u bë verifikimi i llogaritjes së amortizimit sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, nga ku rezultoi se llogaritja dhe kontabilizimi i amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara është kryer sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 për Përgatitjen dhe Raportimin e Llogarive Vjetore të vitit 2006, për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive të Menaxhim-Zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huajë, të ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 14, datë 28.12.2006. Fondi i amortizimit për vitin 2018 është në vlerën 206,866,577 lekë. Me shumë ky fond rëndohet për ndërtesat në shumën -49,133,042 lekë, mjete transporti në shumën -80,151,060 lekë, pajisje vegla pune -49,133,042 lekë, inventari ekonomik -11,963,078 lekë, amortizim rrjeti -49,769 lekë. Këto vlera të fondit të amortizimit të paraqitura në bilancin e vitit 2018 janë të barabarta me fondin e amortizimit të paraqitura në programin e kontabilitetit financiar.

Nga DPD janë plotësuar dhe pasqyrat e tjera financiare si formati 3/1 ku pasqyrohen shpenzimet korrente, në vlerën 87,448,038 lekë për vitin 2018, ndërsa shpenzimet e një viti më parë kanë qenë në nivelin e 92,762,604 lekë ose 6% më të ulta se një vit më parë, nga të cilat pagat e personelit me shtesat zënë rreth 63 milion lekë ose 68%; kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore rreth 10 milion lekë ose 11% dhe mallra e shërbime rreth 17 milion lekë ose 15%.

Në formatin 3/2 ÷Të ardhura të ushtrimito jepet informacion mbi të ardhurat e përdorura për vitin 2018, në vlerën 99,974,925 lekë, të cilat përbëhet kryesisht nga granti i brendshëm (Financim nga Buxheti).

Gjithashtu vlera e ndryshimit të gjendjes së inventarit kuadron me llogarinë 63 ÷ndryshim gjendje dhe me pasqyrat e inventarit të vitit 2018 (në shumën -3,751,385 leke).

Pasqyrat financiare sa më sipër janë plotësuar korrektësisht ku në fund të tyre jepen shpjegime për rubrikat e plotësuar . Gjithashtu bashkëlidhur pasqyrave financiare janë të vendosura situacionet e konfirmuara nga thesari për të ardhurat dhe shpenzimet.

Mbi pasqyrat financiare të vitit 2019

Edhe për këtë vit dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Nga verifikimi i veprimeve për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2019 rezulton se, llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike dhe janë të hedhura korrektësisht në pasqyrat financiare të Aktivit dhe të Pasivit, ndërsa në programin të kontabilitetit ku dalin të gjitha llogaritë e gjendjeve ka problem subjektive të cilat nuk pasqyrojnë barazime të shifrave të bilancit me shifrat e programit të kontabilitetit. Kjo vjen për pasojë të mosfunksionimit dhe përdorimit të saktë të programit Financa 5 nga specialistët e financës në DPD.

Pasqyrat financiare të vitit 2019 janë të shoqëruara me situacionin e të ardhurave dhe shpenzimeve të konfirmuara nga thesari si dhe nxjerrjen e thesarit të datës 31.12.2019.

Pasqyrat financiare të Aktivit dhe Pasivit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2019 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tab. 2

AKTIVI	Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2019 (në bilanc)	Gjendje në fund të vitit 2019(në programin e kontabilitetit)	Diferenca gjendje bilanci me gjendje kontabilitetit viti 2019
A.	<i>Aktive të qëndrueshme</i>	284,564,999	284,564,999	0
20, 230	Aktive të patrupëzuara	19,663,560	19,663,560	0
21,23,24,28	Aktive të trupëzuara	264,901,439	264,901,439	0
B	<i>Aktive qarkulluese</i>	28,328,266.11	36,187,537	7,859,271
31,32	Gjendja e inventarit	16,121,150	16,120,107	1,043
411-418437,438, 4342, 468.	Kërkesa arkëtimi mbi debitorë	7,048,663	6,903,963	144,700
50.59	Llogaritë financiare	5,060,310.11	13,163,466.65	8,103,167
C	<i>Llogari të tjera aktive</i>	98,143	0	98,143
	Rezultati i ushtrimit (Saldo debitorë)	-		
Totali i Aktivit		312,893,265.11	320,752,536	7,859,271
PASIVI	Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2019 (në bilanc)	Gjendje në fund të vitit 2019(në programin e kontabilitetit)	Diferenca gjendje bilanci me gjendje kontabilitetit viti 2019
A	<i>Fondet e veta</i>	300,686,149	8,549,631	292,136,518
10-15	Fonde të veta	300,686,149	8,549,631	292,136,518
B	<i>Detyrime</i>	12,207,116	11,592,082	615,030
41-46	Detyrime afatshkurtër	11,790,966.11	11,592,082	198,880
C (47-48)	<i>Llogari të tjera</i>	416,150	0	416,150
85	Rezultati i ushtrimit (Saldo kreditorë)	-		
Totali i Pasivit		312,893,265.11	20,141,713	292,751,548

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Nga analiza e llogarive të bilancit për vitin 2019 të DPD, rezulton;

Aktivi i bilancit të institucionit, në fund të vitit 2019 është **312,893,265.11** lekë i barabartë me pasivët e bilancit **312,893,265.11** lekë. Nga auditimi rezulton se të dhënat e aktivit të bilancit

per vitin 2019 nuk kuadrojne me llogarite e gjendjeve te regjistruara ne ne programin e kontabilitetit, në shumën **320,752,536** lekë.

Nga analiza Konstatimet e bera nga grupi i auditimit per moskuadrimin e pasqyres financiare (bilanci) me te dhenat e programit te kontabilitetit te vitit 2019: diferenca ne shumen **7,859,271** lekë - ne zerin inventare ekziston nje difference prej 1,043 lekë (shuma ne bilanc eshte 16,121,150 leke, ndersa ne programin e kontabilitetit eshte 16,120,107 leke); llogaria kerkesa arketimi mbi debitoret, diferenca ne shumen 144,700 lekë (eshte shuma e detyrimeve te DPD per taksen portuale te kreditoret dmth te klientet te cilet pasqyrohen ne janar te vitit qe vjen. Ne zerin llogari financiare ne bilanc rezulton shuma 5,060,310 leke, ndersa ne programin financiar shuma 13,163,466.65 leke, diferenca 8,103,167 lekë. Shuma 5,060,310 lekë perben llogarine 520 Disponibilitete ne Thesar (me akt rakordimin e Thesarit dega Durres , sa vlera e arketuar por e pa derdhur e taksës portuale=46,095.11 leke, vlera e arketuar por e pa derdhur e pasaportes se lundrimit = 92,000 leke,5% Garanci Difektesh =46,095.11 lekë), llogaria 466 ò Kreditore per mjete ne ruajtjeò = 5,060,310 leke, Llogaria 468 ò Debitore te ndryshemò=134,700 leke, llogaria 4342 òOperacione me shtetin (debitor)=6,551,388 lekë qe jane Llogarinë 42 òPersoneli dhe llogari të lidhur me toò në vlerën 4,524,243 lekë,shuma që përfaqësojnë pagat e muajit Dhjetor 2019, Llog. 435 dhe 436 òSigurime Shoqërore dhe Shëndetësoreò përkatësisht në vlerat 1,369,990 lekë dhe 190,981 lekë, si dhe TAP (tatim mbi te ardhurat personale) ne shumen 466,174 lekë. Shuma 1,551,768.65 lekë perbehet nga fondi i ngurtesuar te trasheguar.

Persa i perket pasivit te bilancit te vitit 2019 shuma e tij eshte e barabarte me aktivin e bilancit 312,893,265.11 leke, ndersa ne llogarite e gjendjeve te pasivit te programit te kontabilitetit shuma eshte 20,141,713 lekë. Diferenca **292,751,548** lekë perbehet nga llogaria Fondet e veta ,llogaria detyrimet afatshkurtera 198,880 lekë dhe llogaria detyrime te tjera 416,150 lekë. .

Llogaria 212, òNdërtime e konstruksioneò paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën prej 137,283,459 lekë. Theksojmë se DPD ka ndryshim të llogarisë 212 òNdërtime e konstruksioneò gjatë vitit 2019 ne shumen 172,988,845 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i shtimit te investimit dhe te regjistruar ne kete llogari.

Gjithashtu gjatë vitit 2019 ka ndryshuar në ulje dhe llogaria 215 òmjete transportiò, si rezultat i rritjes se vleres se amortizimit te tyre ne vleren 85,627,280 leke, kjo con ne ndryshimin e vleres neto te mjeteve te transportit ne 21,904,880 nga kostoja historike 107,532,160 lekë. Shifrat e vendosura në pasqyrën e aktivitet të bilancit për AQT dhe AQ patrupëzuara rakordojnë me formatin nr. 7/a të pasqyrave financiare Gjendja dhe ndryshimet e AQ.

Llogaria 31 òMaterialeò, në vitin 2019 paraqitet me vlerën 19,801,954 lekë, në fund të vitit 2019 paraqitet me vlerën 16,121,150 lekë. Ka një ulje të inventarëve per vitin 2019 per shkak te nxjerrjes jashte perdorimit ne llogarine materiale.

Pasivi i bilancit për vitin 2019, është i njëjtë me aktivin dhe në shumën **312,893,265.11** lekë ku fondet e veta të DPD janë në shumën 300,686,149 lekë, detyrime afatshkurtra janë 12,207,116 lekë.

Ne llogarite e gjendjeve te programit sintetik te kontabilitetit te institucionit fondet e veta të DPD janë në shumën 8,549,631 lekë, detyrime afatshkurtra janë 11,592,082 lekë. Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit rezulton moskuadrin i fondeve te veta te paraqitura ne bilanc ne shumen 292,751,548 lekë me me shumen e fondeve te veta te paraqitura ne programin financiar te institucionit te DPD.

DPD ka shuma në Llogarinë 42 òPersoneli dhe llogari të lidhur me toò në vlerën 4,524,243 lekë,

Llog. 435 dhe 436 òSigurime Shoqërore dhe Shëndetësoreò përkatësisht në vlerat 1,369,990 lekë dhe 190,981 lekë, si dhe TAP (tatim mbi te ardhurat personale) ne shumen 466,174 lekë. Këto shuma që përfaqësojnë pagat e muajit Dhjetor 2018, kontributin e sigurimeve shoqërore

dhe shëndetësore, të cilat janë likuiduar në janar 2020, me fondet buxhetore të planifikuara për këtë vit buxhetor.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPD lidhur me pasqyrat financiare ne zerin Personeli dhe llogari të lidhur me të vitit 2019, grupi i auditimit konstatoi një mosperputhje të pagave të raportuar në bilanc me vlerë 4,524,243 lekë dhe pagave të regjistruar në programin financiar të DPD me vlerë 1,893,056 lekë. Në qoftë se i referohemi të gjithë detyrimit vjetor të pagave 2019 kanë qenë në shumën 56,184,154 lekë. Likuidimi i institucionit për gjithë vitin 2019 është në vlerën 58,077,210 lekë dhe diferenca është në debi të kësaj llogarie në shumën 1,893,056 lekë. Kjo diferencë është e mbartur në vitet e mëparshme u la detyrë të sistemohet në vitin në vazhdim.

Gjithashtu në programin e kontabilitetit në llogarinë 581 xhirime të brendshme ekziston një diferencë në debi të kësaj llogarie në shumën 1,831,732 lekë. Nga konstatimet dhe diskutimet e grupit të auditimit me specialistet e sektorit të financës u theksua se kjo shumë është e trashëguar në vitet e mëparshme. Theksojmë se Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk bën veprime me arke. Kjo shumë ka të bëjë me fonde të ngurtësuar 5% Garanci Diferencë, e cila është e trashëguar nga vitet e mëparshme. Dhe për këtë u la detyrë sistemimi në vitin në vazhdim.

Nga DPD janë plotësuar dhe pasqyrat e tjera financiare si formati 3/1 ku pasqyrohen shpenzimet korrente, në vlerën 97,259,698 lekë për vitin 2019 ku shpenzimet e një viti më parë 2018 kanë qenë në nivelin e 92,762,604 lekë ose 3 % më larta se një vit më parë, nga të cilat pagat e personelit me gjithë përfitimet e tyre zënë rreth 70 milion lekë ose 77 %, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore rreth 11 milion lekë ose 12 % dhe mallra e shërbime rreth 11 milion lekë ose 11 %.

Në formatin 3/2 Të ardhura të ushtrimit jepet informacion mbi të ardhurat e përdorura për vitin 2019, në vlerën 101,551,117 lekë, të cilat përbëhet kryesisht nga grandit i brendshëm (leke Financim nga Buxheti). Gjithashtu vlera e ndryshimit të gjendjes së inventarit kuadron me llogarinë 63 ndryshim gjendje dhe në pasqyrat e inventarit të vitit 2019 në shumën 3,680,804 lekë.

Pasqyrat financiare për vitin 2018 dhe 2019 sa më sipër janë plotësuar korrektësisht ku në fund të tyre jepen shpjegime për rubrikat e plotësuar. Gjithashtu bashkëlidhur pasqyrave financiare janë të vendosura situacionet e konfirmuara nga thesari për të ardhurat dhe shpenzimet.

Rakordimi i buxhetit faktik me të dhënat e kontabilitetit për vitin 2018 dhe 2019.

Viti 2018 Tab. 3 (Në 000/leke)

Llogaria	Pershkrimi	Fakti sipas buxhetit	Fakti sipas kontabilitetit	Diferenca
600	Paga, sigurime shoqërore	63,199	63,199	-
601	Sigurime shoqërore	10,395	10,395	-
602	Mallra shërbime	17,535	17,535	-
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	70	70	-
231	Shpenzime kapitale të trupëzuara Ndertimi sistemit LRIT	24,560	23,881	679
231	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231) Rikonstruksioni Godines Kapiteneria Shëngjin	10,978	20,978	10,000
	Total	126,737	136,058	10,679

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Viti 2019 Tab. 4 (Në 000/leke)

Llogaria	Pershkrimi	Fakti sipas buxhetit	Fakti sipas kontabilitetit	Diferenca
----------	------------	----------------------	----------------------------	-----------

600	Paga, sigurime shoqerore	70,106	70,106	-
601	Sigurime shoqerore	11,638	11,638	-
602	Mallra sherbime	11,835	11,835	-
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individet	-	-	-
231	Shpenzime kapitale të trupëzuara Ndertimi sistemit LRIT	44,374	0	44,374
	Total	137,953	93,579	44,374

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

1.3 Detyrimet debitore dhe kreditore

Për vitin 2018 këto detyrime paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tab. 5 Në lekë

Llogari arkëtueshme te	Gjendja në fund te vitit 2018	Analiza e llogarisë
412	5,129	Detyrimi i DPD. ndaj klientit .Derdhur paradhanie nga klientet per taksen portuale per vitin 2018.(41.25 euro *124.33 kursi i BSH date 31.12.2018=5,129 leke)
4342	6,042,552	Sa detyrimi I mbartur për likuidim ne 2019 përbehet nga:paga 4,171,611,tatim 432,519,sig shoq 1,262,248,sig shëndetësor 176,174, te muajit dhjetor 2018
437	847,846	Detyrimi i klienteve ndaj DPD.Sa vlere e t.portuale derdhur paradhanie nga agjencitë (6,819.3 eur0*124.33 lek kursi I BSH dt 31.12.2018)
468	134,700	Debitore për gjoba :A.J. 104700; A.O. 15,000,Anija T. 15,000
Shuma	7,030,227	

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Shuma e detyrimeve të DPD në fund të 2018 kundrejt të tretëve është vlere **7,030,227**lekë. Detyrimet e DPD janë të muajit janar të vitit 2019 dhe janë detyrimet për paga, derdhjet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimore si dhe taksat e grumbulluara në Dhjetor dhe që derdhen në Janar të 2019 në favor të tatimeve .

Ndërsa për vitin 2019 detyrime paraqiten në tabelën nr. 6:

Tab. 6 Në lekë

Llogari arkëtueshme te	Gjendja në fund te vitit 2019	Analiza e llogarisë
412	83,000	Derdhur paradhanie nga klientet per taksen portuale per vitin 2019.(668 euro *124.33 kursi i BSH date 31.12.2018=83.000 leke)
4342	6,551,388	Sa detyrimi I mbartur për likuidim ne 2019 përbehet nga:paga 4,524,243,tatim 466,174,,sig shoq 1,369,990,sig shëndetësor 190,981, te muajit dhjetor 2019
437	362,575	Sa vlere e t.portuale derdhur paradhanie nga agjencitë (2,916 euro*124.23 lek kursi I BSH dt 31.12.2016)
468	134,700	Debitore për gjoba :A.J. 104700; A.O. 15,000,Anija T. 15,000
Shuma	7,131,663	

Burimi: DPD, perpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Shuma e detyrimeve të DPD në fund të 2019 është vlere **7,131,663** lekë, detyrime të muajit janar të vitit 2020 dhe janë detyrimet për paga, derdhjet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimore si dhe 5% i garancisë së punimeve në kullën e vrojtimit. Këtu përfshihen dhe taksat e grumbulluara në Dhjetor dhe që derdhen në Janar të 2020 në favor të tatimeve.

Për shumën 134,700 lekë debitore për gjoba : A.J 104,700 lekë; A. O 15,000 lekë, A. T 15,000 lekë nuk rezultoi që të kishte proces gjyqësor të hapur dhe këto kompani aktualisht nuk janë më në treg (detyrime të mbartura prej shumë vitesh). Detyrimet e vitit 2019 jane me te larta se detyrimet e vitit 2018 ne shumen 101,436 lekë me shume ne vitin 2019. Keto detyrime jane rritur per shkak te rritjes se numrit te punonjesve ne Drejtorine e Pergjithshme Detare. Detyrime te prapambetura jane detyrimet nga debitore te ndryshme qe jane ne vleren

134,700 lekë. Ky detyrim është i mbartur dhe në vitin 2018, dhe në vitin 2019. I bie detyre institucionit të arketojë këto detyrime.

1.4 Kryerja e inventarit të pasurisë së institucionit për vitet 2018 dhe 2019.

Inventarizimi është mbështetur në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 për menaxhimin e kontrollin financiar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pikat 73-103. Në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, përcaktohet detyrimi i drejtimit të procedurave për inventarizimin e pasurisë, të paktën një herë në vit. Në nenin 7 shprehet: "Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore."

Nga auditimi i dokumentacionit për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në Drejtorinë e Përgjithshme Detare për vitin 2018 dhe vitin 2019 rezultoi se:

Për vitin 2018, me shkresën nr.1320, datë 12.11.2018 ka dalë urdhri nr.103, datë 12.11.2018 i Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare z. P.N., për ngritjen e komisionit të inventarizimit i për DPD Durrës, për Kapitaneritë e porteve Vlorë, Shëngjin e Sarandë, ku për secilën janë ngritur komisionet përkatëse. Në bazë të këtij urdhri janë ngritur 4 komisione me nga tre anëtarë secili që do të mbulojnë inventarizimin në secilin nga subjektet sa më sipër. Procesi i inventarizimit ka filluar me datën 16.11.2018. për të përfunduar me 30.11.2018, ndërsa për Magazine Qendrore inventari do të fillojë do të fillojë 24.12.2018 dhe do të përfundojë në datë 28.12.2018. Sa më sipër janë përgatitur nga komisionet raportet për titullarin dhe në këto raporte jepet fakti i përputhjes së inventarit fizik me atë kontabël dhe fakti i gjendjes jashtë përdorimi i konstatuar nga grupet e inventarizimit. Për nxjerrje jashtë përdorimi ka propozime vetëm nga komisioni i DPD Durrës.

Nga titullari i institucionit janë ngritur me urdhrin e brendshëm nr.104, datë 12.11.2018 dhe me nr.1321 protokoll komisioni i vlerësimit si dhe komisioni i asgjësimit të AQ të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi. Secili nga komisionet ka mbajtur procesverbalet përkatëse të mbajtura me datën 31.12.2018. Në bazë të procesverbaleve të mbajtura titullari ka nxjerrë urdhrin me nr.1320/1 datë 03.01.2019, për veprime të mëtejshme në sektorin e financës për shumën e nxjerrjes jashtë përdorimit. Nga veprimet rezultoi se janë kryer veprimet përkatëse në kontabilitet për inventarin ekonomik në pakësim në shumën 237,340 lekë shumën nga objekte inventari klasa 3 (materiale në përdorim) . Nga konstatimi I grupit të auditimit rezultoi se shumën e nxjerrjes jashtë përdorimi të klases 3 objekte inventari është 222,940 lekë ,pra një diferencë 14,400 lekë është vlera e vulave të nxjerrjes jashtë përdorimit.

Për vitin 2019, me shkresën nr.2373 , datë 21.11.2019 ka dalë urdhri nr.122, datë 21.11.2019 i Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare z. P.N., për ngritjen e komisionit të inventarizimit i për DPD Durrës, për Kapitaneritë e porteve Vlorë, Shëngjin e Sarandë, ku për secilën janë ngritur komisionet përkatëse. Në bazë të këtij urdhri janë ngritur 4 komisione me nga tre anëtarë secili që do të mbulojnë inventarizimin në secilin nga subjektet sa më sipër. Procesi i inventarizimit ka filluar me datën 2.12.2019, për të përfunduar me 13.12.2019, ndërsa për Magazine Qendrore inventari do të fillojë do të fillojë 23.12.2019 dhe do të përfundojë në datë 27.12.2019. Sa më sipër janë përgatitur nga komisionet raportet për titullarin dhe në këto raporte jepet fakti i përputhjes së inventarit fizik me atë kontabël dhe fakti i gjendjes jashtë përdorimi i konstatuar nga grupet e inventarizimit. Për nxjerrje jashtë përdorimi ka propozime vetëm nga komisioni i DPD Durrës.

Nga titullari i institucionit janë ngritur me urdhrin e brendshëm nr.123, datë 21.11.2019 dhe me nr.2373/1 protokoll komisioni i vlerësimit si dhe komisioni i asgjësimit të AQ të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi. Secili nga komisionet ka mbajtur procesverbalet përkatëse të mbajtura me datën 31.12.2018. Në bazë të procesverbaleve të mbajtura titullari ka nxjerrë urdhrin me nr. 2373/2 datë 06.01.2020 , për veprime të mëtejshme në sektorin e financës për shumat e nxjerra jashtë përdorimit. Nga veprimet rezultoi se janë kryer veprimet përkatëse në kontabilitet për inventarin ekonomik në pakësim në shumën 8,572,791 lekë shuma nga objekte Aktive te Qendrueshme te Trupezuara dhe inventari klasa 3 (materiale në përdorim) në shumën 76,007 lekë. Nga konstatimi I grupit te auditimit rezultoi se shuma e nxjerrjes jashte perdorimi te klases 3 ÷Objekte inventariö eshte 76,007 lekë. Nga konstatimi I grupit te auditimit rezultoi se shuma e nxjerrjes jashte perdorimi te Aktiveve te Qendrueshme te Trupezuara eshte 8,573,631 leke, ndersa ne process verbalet e dorezuara eshte 8,573,631 lekë , pra jane te barabarta.

Llogaritë e Aktivit të bilancit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, në fund të vitit 2019 janë të barabarta me llogaritë e pasivit të këtij viti, ose në Shumën 312,893,265.11 lekë. Nga grupi i auditimit konstatohet se dhe për vitin 2019 llogaritë e pozicionit financiar (në pasqyrat financiare) nuk janë të barabarta me llogaritë e gjendjeve në fund të vitit, në programin e kontabilitetit të DPD. Shuma e llogarive të aktivit në programin e kontabilitetit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin 2019 rezulton shuma 320,752,536 lekë, pra me një diferencë në shumën 7,859,271 lekë (më shumë në programin e kontabilitetit, krahasuar me pasqyrat financiare).

Në zërin ÷llogari financiareö në bilanc rezulton shuma 5,060,310 leke, ndërsa në programin financiar shuma 13,163,466.65 lekë, diferenca 8,103,167 lekë:

- Shuma prej 5,060,310 lekësh i përket llogarisë 466 ÷Kreditorë për mjete në ruajtjeö;
- Shuma 134,700 lekë për llogarinë 468 ÷Debitore të ndryshëmö
- Llogaria 4342 ÷Operacione me shtetinö (debitor) prej 6,551,388 lekë, që zërthehet në Llogarinë 42 ÷Personeli dhe llogari të lidhur me toö në vlerën 4,524,243 lekë (shuma që përfaqësojnë pagat e muajit Dhjetor 2019), Llog. 435 dhe 436 ÷Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësoreö përkatësisht në vlerat 1,369,990 lekë dhe 190,981 lekë, si dhe TAP (tatim mbi te ardhurat personale) në shumën 466,174 lekë.
- dhe Shumën 1,551,768.65 lekë që përbën fondin e ngurtësuar të trashëguar.
- Pasqyra e aktivit të bilancit për AQT dhe AQ patrupëzuara rakordon me formatin nr. 7/a të pasqyrave financiare ÷Gjendja dhe ndryshimet e AQö.
- Në vitin 2018 Llogaria 31 ÷Materialeö, paraqitet me vlerën 19,801,954 lekë, ndërsa në fund të vitit 2019 ka zbritur në vlerën 16,121,150 lekë, meqenëse është zvogëluar vlera e inventarëve për shkak të nxjerrjes jashtë përdorimit të artikujve, në llogarinë ÷materialeö.
- Nga analiza e zërave të llogarive, konstatohet se në llogaritë e gjendjeve të programit të kontabilitetit të DPD paraqiten si vijon: - për Llogarinë 42 ÷Personeli dhe llogari të lidhur me toö në vlerën 4,524,243 lekë, Llog. 435 dhe 436 ÷Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësoreö përkatësisht në vlerat 1,369,990 lekë dhe 190,981 lekë, si dhe TAP (tatim mbi te ardhurat personale) në shumën 466,174 lekë, shuma këto përfaqësojnë pagat e muajit Dhjetor 2019, kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë likuiduar në janar 2020, me fondet buxhetore të planifikuara për këtë vit buxhetor.

Theksojmë se Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk bën veprime me arkë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPD lidhur me pasqyrat financiare në zërin ÷Personeli dhe llogari të lidhur me toö të vitit 2019, grupi i auditimit konstatoi një mosperputhje të pagave të raportuara në bilanc me një shumë prej 4,524,243 lekë dhe pagave të regjistruara në programin e kontabilitetit me një shumë prej 1,893,056 lekë.

Duke iu referuar të gjithë detyrimit vjetor të pagave v. 2019, i cili ka qenë në shumën 56,184,154 lekë. Likuidimi i institucionit për gjithë vitin 2019 është në vlerën 58,077,210 lekë dhe diferenca është në debi të kësaj llogarie në shumën 1,893,056 lekë.

Nga DPD janë plotësuar dhe pasqyrat shoqëruese financiare si formati 3/1 ku pasqyrohen shpenzimet korrente, në vlerën 97,259,698 lekë për vitin 2019, ndërsa shpenzimet e vitit 2018 kanë qenë në nivelin 92,762,604 lekë. Shpenzimet e vitit 2019 janë rreth 3 % më larta se shpenzimet e vitit 2018. Shpenzimet e vitit 2019 përbehen nga pagat e personelit me shtesat të cilat zënë rreth 70 milion lekë ose 77 %, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore rreth 11 milion lekë ose 12 % dhe mallra e shërbime rreth 11 milion lekë ose 11 %.

Në formatin 3/2 òTë ardhura të ushtrimitò jepet informacion mbi të ardhurat e përdorura për vitin 2019, në vlerën 101,551,117 lekë, të cilat përbëhen kryesisht nga granti i brendshëm (financim nga buxheti). Gjithashtu vlera e ndryshimit të gjendjes së inventarit kuadron me llogarinë 63 òndryshim gjendjeò; e cila është pasqyruar në pasqyrën e inventarit të vitit 2019 në shumën 3,680,804 lekë.

Në fund të pasqyrave financiare jepen shpjegime për rubrikat e plotësuara dhe janë bashkëlidhur situacionet e konfirmuara nga thesari për të ardhurat dhe shpenzimet. për vitin 2018 dhe 2019.

Shuma e detyrimeve të DPD në fund të 2018 kundrejt të tretëve është vlera 7,030,227lekë, të cilat janë detyrimet për paga, derdhjet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimore si dhe taksat e grumbulluara në Dhjetor dhe që derdhen në Janar të 2019 në favor të tatimeve.

Ndërsa për vitin 2019 detyrime paraqiten si në tabelën tek anekset e Projekt Raportit.

Shuma e detyrimeve të DPD në fund të 2019 është vlera 7,131,663 lekë, detyrime të muajit janar të vitit 2020 dhe janë detyrimet për paga, derdhjet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimore si dhe 5% i garancisë së punimeve në kullën e vrojtimit. Këtu janë përfshirë dhe taksat e grumbulluara në Dhjetor dhe që derdhen në Janar të 2020 në favor të tatimeve.

Për shumën 134,700 lekë, debitore për gjoba: A.J 104,700 lekë; A. O 15,000 lekë, A. T 15,000 lekë, nuk rezultoi që të kishte proces gjyqësor të hapur dhe këto kompani aktualisht nuk janë më në treg (detyrime të mbartura prej shumë vitesh). Detyrimet e vitit 2019 janë më të larta se detyrimet e vitit 2018 në shumën 101,436 leke, detyrime të cilat janë rritur për shkak të rritjes së numrit të punonjesve në Drejtorinë e Përgjithshme Detare. Detyrime të prapambetura janë detyrimet nga debitorë të ndryshëm në vlerën 134,700 lekë, detyrim ky që është i mbartur si për vitin 2018 edhe për vitin 2019.

1.4 Kryerja e inventarit të pasurisë së institucionit për vitet 2018 dhe 2019.

Inventarizimi është mbështetur në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 òPër menaxhimin e kontrollin financiar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pikat 73-103. Në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, përcaktohet detyrimi i drejtimit të procedoi për inventarizimin e pasurisë, të paktën një herë në vit. Në nenin 7 shprehet: òNjësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetoreò.

Nga auditimi i dokumentacionit për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në Drejtorinë e Përgjithshme Detare për vitin 2018 dhe vitin 2019 rezultoi se:

Për vitin 2018, me shkresën nr.1320, datë 12.11.2018 ka dalë urdhri nr.103, datë 12.11.2018 i Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare z. P.N., për ngritjen e komisionit të inventarizimit i për DPD Durrës, për Kapitaneritë e porteve Vlorë, Shëngjin e Sarandë, ku për

secilën janë ngritur komisionet përkatëse. Në bazë të këtij urdhri janë ngritur 4 komisione me nga tre anëtarë secili që do të mbulojnë inventarizimin në secilin nga subjektet sa më sipër. Procesi i inventarizimit ka filluar me datën 16.11.2018. për të përfunduar me 30.11.2018, ndersa per Magazine Qendrore inventari do te filloje do te filloje 24.12.2018 dhe do te perfundoje ne date 28.12.2018. Sa më sipër janë përgatitur nga komisionet raportet për titullarin dhe në këto raporte jepet fakti i përputhjes së inventarit fizik me atë kontabël dhe fakti i gjendjes jashtë përdorimi i konstatuar nga grupet e inventarizimit. Për nxjerrje jashtë përdorimi ka propozime vetëm nga komisioni i DPD Durrës.

Nga titullari i institucionit janë ngritur me urdhrin e brendshëm nr.104, datë 12.11.2018 dhe me nr.1321 protokoll komisioni i vlerësimit si dhe komisioni i asgjësimit të AQ të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi. Secili nga komisionet ka mbajtur procesverbalet përkatëse të mbajtura me datën 31.12.2018. Në bazë të procesverbaleve të mbajtura titullari ka nxjerrë urdhrin me nr.1320/1 datë 03.01.2019, për veprime të mëtejshme në sektorin e financës për shumat e nxjerra jashtë përdorimit. Nga veprimet rezultoi se janë kryer veprimet përkatëse në kontabilitet për inventarin ekonomik në pakësim në shumën 237,340 lekë shuma nga objekte inventari klasa 3 (materiale në përdorim). Shuma e nxjerrjes jashte perdorimi te klases 3 ÷Objekte inventariö eshte 222,940 leke, pra nje diference 14,400 lekë eshte vlere e vulave te nxjerra jashte perdorimit.

Për vitin 2019, me shkresën nr. 2373 , datë 21.11.2019 ka dalë urdhri nr.122, datë 21.11.2019 i Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare z. P.N., për ngritjen e komisionit të inventarizimit i për DPD Durrës, për Kapiteneritë e porteve Vlorë, Shëngjin e Sarandë, ku për secilën janë ngritur komisionet përkatëse. Në bazë të këtij urdhri janë ngritur 4 komisione me nga tre anëtarë secili që do të mbulojnë inventarizimin në secilin nga subjektet sa më sipër. Procesi i inventarizimit ka filluar me datën 2.12.2019, për të përfunduar me 13.12.2019, ndersa per Magazine Qendrore inventari do te filloje do te filloje 23.12.2019 dhe do te perfundoje ne date 27.12.2019. Sa më sipër janë përgatitur nga komisionet raportet për titullarin dhe në këto raporte jepet fakti i përputhjes së inventarit fizik me atë kontabël dhe fakti i gjendjes jashtë përdorimi i konstatuar nga grupet e inventarizimit. Për nxjerrje jashtë përdorimi ka propozime vetëm nga komisioni i DPD Durrës.

Nga titullari i institucionit janë ngritur me urdhrin e brendshëm nr.123, datë 21.11.2019 dhe me nr.2373/1 protokoll komisioni i vlerësimit si dhe komisioni i asgjësimit të AQ të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi. Secili nga komisionet ka mbajtur procesverbalet përkatëse të mbajtura me datën 31.12.2018. Në bazë të procesverbaleve të mbajtura titullari ka nxjerrë urdhrin me nr. 2373/2 datë 06.01.2020 , për veprime të mëtejshme në sektorin e financës për shumat e nxjerra jashtë përdorimit. Nga veprimet rezultoi se janë kryer veprimet përkatëse në kontabilitet për inventarin ekonomik në pakësim në shumën 8,572,791 lekë shuma nga objekte Aktive te Qendrueshme te Trupezuara dhe inventari klasa 3 (materiale në përdorim) në shumën 76,007 lekë. Shuma e nxjerrjes jashte perdorimi te klases 3 ÷Objekte inventariö eshte 76,007 lekë. Shuma e nxjerrjes jashte perdorimi te Aktiveve te Qendrueshme te Trupezuara eshte 8,573,631 lekë, ndërsa në procesverbalet e dorëzuara është 8,573,631 lekë, pra janë të barabarta.

Konstatime shtesë gjatë hartimit të Raportit lidhur me sektorin e financës së DPD-së.

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Pasqyrat financiare të DPD për v. 2018 dhe 2019
- 2) Evidenca kontabël e Shoqërisë (librat, regjistrat kontabël, etj.) për v. 2018, 2019 dhe 3 mujori I-rë 2020.
- 3) -Ditari i regjistrimit të veprimeve të kryera.
- 4) -Dokumentacioni shoqërues i veprimeve kontabel.
- 5) -Dokumentacionet justifikues, etj.

Është respektuar afati i dorëzimit të bilancit për vitin 2018 ne Degen e Thesarit Durres me shkrese percjellese Nr.986, date 19.03.2019, i firmosur nga Drejtori I Pergjithshem Detar z.P.N., si dhe dorezimi i bilancit per vitin 2019 me shkrese percjellese Nr. 1036, date 18.03.2020, i firmosur nga Drejtori i Përgjithshem Detar z.P.N., Dega e Thesarit Durres ka vulosur cdo faqe te pasqyrave financiare te vitit 2018 dhe vitit 2019, ndersa pyetsoret dhe shenimet shpjeguese per raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2018 dhe 2019 jane firmosur nga z.I.Sh. hartues i llogarise vjetore dhe firmosur e vulosur z.P.N. Drejtori i Pergjithshem Detar.

Pasqyrat financiare per vitin ushtrimor 2018 dhe 2019 përbëhen:

- 1.Pozicioni financiar (bilanci)
- 2.Pasqyra e performances financiare (pasqyra e shpenzimeve dhe te ardhurave)
- 3.Pasqyra e Flukseve Monetare (CASH/FLOW)
- 4.Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/fondet neto.
- 5.Pyetsori dhe shenimet shpjeguese.
- 6.Pasqyra e investimeve dhe burimeve te financimit
- 7.Pasqyra e gjendjeve dhe e ndryshimeve te Aktiveve Afatgjata (me kosto historike)
8. Pasqyra e gjendjeve dhe e ndryshimeve te Aktiveve Afatgjata (me vlere neto)
- 9.Pasqyra e numrit te punonjesve dhe fondi I pagave.
- 10.Situacioni per periudhen 1 Janar ___ 31 Dhjetor 2018, dhe 2019 (firmosur nga Drejtor I Sherbimeve Mbeshtetese zj.F.I. dhe firmosur dhe vulosur nga z.P.N. Drejtori i Pergjithshem Detar, si dhe Firmosur dhe vulosur nga specialistja e Deges se Thesarit Durres zj. Xh.N.).
- 11.Rakordimi mujor ui te ardhurave 1 Janar ___31 Dhjetor 2018 dhe 2019 (firmosur nga Drejtor I Sherbimeve Mbeshtetese zj.F.I. dhe firmosur dhe vulosur nga z.P.N. Drejtori i Pergjithshem Detar, si dhe Firmosur dhe vulosur nga specialistja e te ardhurave e Deges se Thesarit Durres zj. A.L.).
- 12.Akt Rakordimi me date 29.01.2019 dhe 23.01.2020 (mbi 5% garanci per difekte qe trashegohen per vitin 2019 dhe 2020) firmosur dhe vulosur nga Drejtor Sherbimeve Mbeshtetese zj.F.I. dhe firmosur dhe vulosur Firmosur dhe vulosur nga specialistja e Deges se Thesarit Durres zj. Z.Xh.N.
- 13.Akt Rakordimi me date 14.01.2019 dhe 10.01.2020 (mbi llogarine 466 òMjete ne ruajte ò qe trashegohen per vitin 2019 dhe 2020) firmosur dhe vulosur nga Drejtor i Sherbimeve Mbeshtetese zj.F.I. dhe firmosur dhe vulosur Firmosur dhe vulosur nga specialistja e te ardhurave e Deges se Thesarit Durres zj. A.L..

Auditimi i llogarive për vitin 2018 dhe për vitin 2019

Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare për vitet 2018 dhe 2019, është bërë në përputhje me Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ò i ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 òPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njërive që varen prej tyre ò, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 òPër disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ò.

Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Veprimet kontabël në këtë institucion janë në mënyrë elektronike me programin kompjuterik ò financa 5 ò. Janë kontabilizuar veprimet me òBankën ò, òHyrjet dhe daljet e magazinës ò, veprimet lidhur me òPagat ò e veprimet lidhur me shpenzimet operative dhe investimet. Të gjitha veprimet dhe mbylljet e llogarive, të regjistruara në ditarin e bankës, magazinës, ditarin e të ardhurave, janë kryer konform akteve në fuqi. Nga verifikimi i veprimeve për mbylljen e pasqyrave financiare rezulton se, llogaritë sintetike nuk kuadrojnë me ato analitike per rrjedhoje llogarite sintetike nga programi i kontabilitetit nuk jane të hedhura korrektësisht në pasqyrat financiare të Aktivit dhe të Pasivit per vitet 2018 dhe 2019.

Theksojme se shumate e llogarive te paraqitura ne postet e Pasqyres se Pozicionit Financiar korrespondojne me informacionin qe jepet ne Pasqyrat e tjera Financiare dhe Anekset e Pasqyrave financiare. Po ashtu dhe shumate e paraqitura ne Pasqyren Financiare te Levizjes se Mjeteve Monetare (CASH FLOW) jane te rakorduara me situacionet faktike te pagesave dhe arketimeve per vitin 2018.

Mbi pasqyrat financiare të vitit 2018

Nga verifikimi i veprimeve për mbylljen e pasqyrave financiare **te vitit 2018 rezulton se**, llogaritë sintetike nuk kuadrojne kuadrojnë me llogaritë e hedhura në programin financiar te kontabilitetit. Shiko Anekset.

11. Mbi zbatimin e procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr. 8, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

Tabela nr.1, Të dhenat e shkresave në arkiv e protokoll për vitet 2018 dhe 2019.

Viti	Arkiv 2018	Protokoll 2018
	Dokumente te hyra	Dokumente te hyra pa fraksione
	0	1420
		Dokumente te dalese pa fraksione
		260
Viti	Arkiv 2019	Protokoll 2019
	Dokumente te hyra	Dokumente te hyra pa fraksione
	44	2487
		Dokumente te dalese pa fraksione
		282
Viti	Arkiv 2020	Protokoll 2020
	Dokumente te hyra	Dokumente te hyra pa fraksione
	0	1042
		Dokumente te dala pa fraksione fraksionete pa fraksione
		137

Burimi : DPD, përpunimi nga grupi auditues KLSH

Dokumentet e arkivuara per periudhen 2018, 2019, 3 mujori i pare 2020, jane shkresa te cilat jane dokumente te perpunuara ne kete periudhe, te cilat i perkojne periudhes se vitit paraardhes te perpunuara ne arkiv gjate viteve 2018, 2019, 3 mujori i pare 2020. Ne total per periudhen 2018, 2019, 3 mujori i pare 2020, ne protokoll kane hyre dhe dale shkresa, pa perfshire shkresat me fraksione, qe vijne si rezultat i plotesim te vendeve te zena ne regjistrin e protokollit per shkresa dhe mbyllje procedurash per kthim pergjigje. Ne shume raste jane evidentuar shkresa qe kane kaluar afatet kohore per mbylljen e procedurave dhe ato rezultojne te hapura, sidomos shkresa te iniciuara ose te deleguara ne departamentin e ceshtjeve juridike te cilat zgjasin ne kohe. Te gjitha dokumentet e brendshem te cilat i jane derguar nje organi tjeter, jane shoqeruara me shkrese percjellese. Keto dokumente jane te gjitha te protokolluara dhe te firmosura nga titullari i institucionit. Dokumentet qe dalin jashte subjektit shteteror, jane te mbyllura ne zarfe ose ne pako. Ne anen e majte te tyre kane te shenuar adresen e derguesit dhe numri qe ka marre dokumenti ne regjistrin e korrespondences, kurse ne te djathte eshte vene shenimi "sekret" kur dokumenti eshte klasifikuar, dhe vula. Ne dokumentet te cilat jane derguar ne emer te titullarit, mbi zarf vihet shenja "personale". Te gjitha dokumentet e dala jashte subjektit jane te evidentuara ne librin e dorezimit.

Per sa i perket dokumenteve hyrese, ato jane te regjistruara ne regjistrin e korrespondences. Eshte bere shenimi ne to numri i protokollit dhe data e marrjes, i jane dhene titullarit dhe sipas drejtimit, jane shperndare ne sektoret perkates kundrejt firmes. Eshte kontrolluar inventari i dosjeve i cili eshte hartuar nga arkivi ne bashkepunim me sektoret perkates. Eshte konstatuar se inventari i dosjeve, eshte hartuar duke u bazuar ne inventarin e dosjeve te viteve te meparshme,

ne drejtimet e veprimtarise se subjektit dhe ne listen e dokumenteve te subjektit me afatet e ruajtjes. Gjate auditimit eshte konstatuar se jane perpiluar pasqyrat emertuese ne regjister, ne baze te gjitha kriterëve arkivore te cilat jane: te objektit, te autorit, te korrespondentit, te ndarjes territoriale - administrative, te llojit te dokumentit, te kohes. Kjo pasqyre hyn ne fuqi mbasi miratohet nga titullari. Te gjitha pasqyrat emertuese te celjeve te dosjeve jane hartuar vee per ato me vlere ruajtje te perkohshme dhe jane bere ne dy ekzemplar ku njeri qendron ne arkiv qe eshte i pergjithshemper te gjithë sektoret dhe tjetri eshte i veeante per edo sektor dhe ju eshte shperndare sektoreve perkatese. Zyra Arkivore ne Drejtorine e Pergjithshme Detare eshte zyra qe merret me grumbullimin, perpunimin, ruajtjen fizike e teknologjike) te dokumenteve, si dhe administrimin e venien ne shfrytezim te fondit dokumentar arkivor) Drejtoria e Pergjithshme Detare te, i cili eshte pjese e Fondit Arkivor Kombetar. Bazuar ne rregulloren e brendshme te Drejtorise se Pergjithshme Detare detyrat e Zyres Arkivore jane:

Pranimi i dokumenteve nga sekretaria e sektoret si dhe evidentimi i tyre ne regjistrin e inventarit te fondit. Perpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve. Ruajtja fizike e teknologjike e dokumenteve pasurise dokumentare) qe ndodhet ne Arkiv nepermjet pastrimit te ambienteve dhe sigurimit te kushteve te ruajtjes). Organizimi punes per shfrytezimin e dokumenteve per plotesimin e kerkesave operative, duke hartuar per kete qellim edhe mjete te ndryshme informative.

Bazuar ne Ligjin nr.9154 date 06.11.2003 "Per arkivat" dhe ne Rregulloren "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e sherbimit arkivor ne RSH", administrimi i dokumenteve ne zyren Arkivore te Drejtorise se Pergjithshme Detare behet nepermjet:

• Regjistri inventarit te fondeve model 14

• Regjistri inventarit te dokumenteve teknike.

Bazuar ne nenin 42 dhe 43 /a te Ligjit 9154, date 06.11.2003 ,öPer Arkivatö ,ku percaktohet qe dokumentet administrative dorezohen pasi te kene kaluar 10 vjet nga data e krijimit te tyre, Drejtoria e Pergjithshme Detare ka kerkuar me shkresen nr.2473/1 prot.date 16.01.2020, nga Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave dhe nga Drejtoria e Inspektimit dhe Trajnimeve vendosjen ne dispozicion te nje specialisti per ta asistuar institucionin tone ne perpunimin tekniko-shkencor te dokumentave te mbartura ne vite. Ne kuader te bashkepunimit DPA me shkrese nr.3620/73 prot. Date 21.04.2020 ka caktuar person pergjegjes kontakti per sekretari óarkiven inspektorin F.L. ku jane ne pritje te asistences nga ana e tij. DPD ka vene ne dispozicion nepermjet e-mailit informacionin e kerkuar nga personi pergjegjes i caktuar per dhenien e asistences. Per shkak te situates se pandemise Covid -19 eshte vonuar asistenca.

• Regjistri i shfrytezimit model 15.

• Dosja e fondit ku futen keto dokument historiku i fondit krijuesit, procesverbale te pranimit te dokumenteve ne Arkiv dhe dorezimit apo te levizjes se dokumenteve. Vendimet e Drejtorise se Pergjithshme Detare , listen e dokumenteve me afatet e ruajtjes model

11. Listat e vendimit per asgjesim model 10 te dokumenteve qe kane plotesuar afatin e ruajtjes dhe procesverbalet e asgjesimit model 12, inventaret model 7 te dokumenteve RRK dhe te perkohshme).

Aktualisht ne zyren arkivore kryhen keto detyra:

• Marrja e grumbullimi i dokumenteve nga protokolli dhe nga sektoret.

• Perpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve sipas planit.

• Pergatitja dhe dergimi i fotokopjeve te dokumenteve qe kerkohen nga sektoret. Pastrimi dhe sistemimi i dosjeve ne vend ruajtjen e dokumenteve.

• Ndiqen procedurat e verifikimit dhe asgjesimit te dokumenteve qe kane plotesuar afatin e ruajtjes.

2. Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese si dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua urdhri nr. 06, datë 30.01.2018, me nr. 59 prot., DPD, me anë të të cilit është ngritur një grup pune për të marrë masa për realizimin e rekomandimeve të lëna në DPD pas auditimit të kryer nga Organizata Ndërkombëtare e Detarisë (IMO). Auditimi nga IMO për DPD-në, është kryer nga data 23 deri në datën 30 Maj të vitit 2016. Afatet e zbatimit të 10 rekomandimeve të propozuara, variojnë nga muaji Tetor i vitit 2018 deri në muajin Dhjetor të vitit 2019 sipas rëndësisë së rekomandimit. Drejtori i Drejtorisë Detare Durrës, i ka dërguar një relacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 1606 prot., datë 19.06.2019 në zbatim të shkresës së mësipërme për ndjekjen e realizimit të rekomandimeve të lëna nga IMO. Lidhur me këtë relacion, konstatohet se MIE nuk ka reaguar për realizimin e rekomandimeve të lëna nga IMO. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur tek shkresa dërguar MIE, DPD përcakton se: Drejtoria e Përgjithshme Detare, e ka përgatitur propozimin ligjor për realizimin e rekomandimeve të IMO dhe e ka dërguar në Ministri (sipas relacionit) që në vitin 2018. Momentalisht, vendi ynë renditet në listën e bardhë të IMO-s përsa i përket plotësimit të kriterëve të Konventës STCW (Standards of Training, Certification, and Watchkeeping) por vonesat e hasura për ratifikimin e këtyre ndryshimeve të propozuara nga IMO dhe më pas nga DPD për MIE, do të rezultojnë në rënien e performancës së Flamurit tonë nga lista e bardhë. Avantazhet e ratifikimit dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga IMO për vendin tonë, janë të një rëndësie të veçantë dhe jetike për zhvillimin e mëtejshëm të politikave Detare Shqiptare pse jo edhe për shtimin në numër të anijeve me Flamur Shqiptar e njëkohësisht edhe personelit që operon në fushën e detarisë. Nëse i referohemi ligjit nr. 9254, datë 15.07.2004 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e kombeve të bashkuara për kushtet e regjistrimit të anijeve, (Gjenevë, 7 shkurt 1986) dhe jo vetëm, do të konstatohen avantazhet dhe përfitimet që ka vendi ynë në varësi të renditjes në listën e bardhë të IMO-s. Për referencë që të kuptohet rëndësia e zbatimit të rekomandimeve të IMO nga MIE, mund të referohemi nenit 7 të ligjit të mësipërm për pjesëmarrja e qytetarëve në pronësinë e anijeve dhe/ose ekuipazhimit e anijeve, nenit 8 për pronësinë e anijeve dhe nenit 9 për ekuipazhimin e anijeve përkatësisht pikës 1 dhe pikës 5 së këtij neni.

8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe auditit të brendshëm.

Thelbi i MFK ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, për këtë u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e DPD
- Deklarata per cilesine e kontrollit të brendshëm
- Raporti vjetor për funksionimin e kontrollit te brendshëm
- Pyetësori i vetvlerësimit

Nga auditimi për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296 , datë 8.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, udhëzimeve të Ministrisë së Financave në zbatim të tij, shkresës nr. 6082 prot. datë 16.03.2011 të Ministrisë së Financave, mbi: Hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe Udhëzimit nr. 28 dt. 15. 12.2011 Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësitë publike, u konstatua se:

Me shkresën nr. 340/1 datë 13.01.2019 dhe nr. 16/2 datë 29.01.2020 nga Drejtoria e Përgjithshme Detare janë dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë: Deklarata per cilesine e kontrollit të brendshëm, Raporti vjetor për funksionimin e kontrollit te brendshëm, Pyetësori i vetvlerësimit për vitet 2018 dhe 2019.

Mjedisi i kontrollit. Drejtoria e Përgjithshme Detare në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ka për mision ndjekjen dhe realizimin e veprimtarisë së transportit detar, në bazë të Programit të Qeverisë të Planit Kombëtar të Transportit, masterplaneve dhe Strategjisë së zhvillimit të transportit sidhe monitorimin e zhvillimit të porteve detare. Organizimi i strukturave përbërëse të administratës detare nëpërputhje me legjislacionin në fuqi për fushë e detarisë sidhe marveshjet e konventave ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është pale. Veprimtaria e Administratës Detare, bazohet në Kushtetutën, ligjin Nr. 9251, datë 8.7.2004 òKodi Detar i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, ligjin nr. 10109 dt. 2.4.2009 òPër Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë ligjin Nr 9131, dt 2003 òPer rregullat e etikës në administratën publike, ligjin Nr. 7961, date 12.07.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Me Urdhërin nr. 446 dt. 12.12.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

Duke analizuar përmbajtjen e ligjit nr. 10109 dt. 2.4.2009 òPër administratën detare në RSHë si dhe pozicionet dhe rolet e vendosura në Rregulloren e brendshme konstatohet se ka përputhje ndërmjet këtyre dispozitave (Akteve ligjore, nënligjore dhe strukturave), por struktura organizative duhet të rishikohet kohë pas kohe dhe të modifikohet në rast se gjykohet e nevojshme nga DPD.

Në Drejtorinë Detare Durrës n/autorizues për vitin 2018-2019-2020 është Titullari i Autoritetit, në zbatim të ligjit nr.10296, date 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin ò, i ndryshuar. neni 4, pika 23.

Si rrjedhim në lidhje me elementet përbërës të mjedisit të kontrollit

1-Vendosja e objektivave

2-Integriteti personal dhe etika profesionale ,

3-Struktura organizative në funksion të objektivave të njësisë

4-Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit

5-Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore janë në nivel të mirë, referuar dhe zbatimit në pjesën dërmuese të rekomandimeve të lëna në auditimin e kaluar.

Për periudhën objekt auditimi, edhe pse DPD ka plotësuar në sistemin on-line formularët për vendet e shpallura vakant nga DAP-I rregullisht, institucioni I DPD rezulton përsëri me staf të paplotësuar. Mungon specialist i IT, ka mungesë stafi në sektorin e financës dhe në specialitetin navigacion. Në opinionin tonë si grup auditues i KLSH, mungesa e personelit krijon kushte për risk! Boshllëqet në personelin krijojnë premisa që një nëpunës të kryej më tepër se një funksion në përmbushjen e detyrave në institucion.

Grupi i auditimit konstaton se trajnimet e kryera nga stafi i DPD detare për MFK janë të kufizuara në numër.

Nga audimi rezulton se DPD-së kryhet rregullisht vlerësimi i performancës për punonjësit dhe e dorezon tek Drejtori I Përgjithshëm, në funksion të objektivave të institucionit.

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr. 73 datë 21.04.2016 òPër miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare òndryshuar me Urdhërin nr. 165 datë 8.11.2016 është caktuar Struktura dhe organika e Administratës së DPD Doganore si dhe kriteret e punësimit.

Menaxhimi i Riskut

Menaxhimi i Riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të atyre ngjarjeve ose situatave të dëmshme për arritjen e objektivave të njësisë publike.

Në DPD nuk ka të miratuar një strategji të Riskut, detyrim i neneve 8 (pika 8/a) dhe 10 e 21, pika 2; Në mënyrë më të detajuar, përgjegjshmëria e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, rregullohet nga kjo dispozitë ligjore si më poshtë vijon:

"Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore.

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e Objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike të vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e Objektivave;

h) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

Neni 21, Menaxhimi i riskut,

2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit, si dhe përcaktimet e kreut III, pika 3.2 të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 08, datë 7.11.2016:

"Çdo NjQQ dhe NjQV duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut që përditësohet rregullisht (çdo tre vjet) ose kur në mjedisin e riskut ndodhin ndryshime të rëndësishme, Strategjia duhet të përgatitet nga NA në cilësinë e KR, Titullari i njësisë miraton strategjinë e menaxhimit të riskut, NA analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit".

Gjë që mund të ketë inpakt në arritjen e objektivave të institucionit. Punonjësit nuk kanë njohuri të mjaftueshme në lidhje me procesin e menaxhimit të riskut.

Për periudhën objekt auditimi, janë përgatitur pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve dhe raporti vjetor mbi cilësinë, regjistri i risqeve dhe plani i veprimit për minimizimin e risqeve përkatësisht për vitet 2018, 2019, 2020.

Nga shqyrtimi i plotësimit të pyetësoreve të vetëvlerësimit kanë rezultuar disa mangësi, pasi nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e kapitullit V, të Manualit për MFK. Analiza e të dhënave të pyetësoreve të v. 2018 dhe v. 2019, tregon se, nëpunësi autorizues dhe zbatues nuk kanë bërë vendosjen pikeve sipas kriterëve të vetëvlerësimit, sidhe nuk janë shoqëruar shumica e rubrikave të pyetësorit që kanë vlerësimin me të dobët me shpjegimin e arsyeve dhe me komentet respektive, si çështet në Kapitullin III, Hapi III, kreu "Procesi i Implementimit të MFK" dhe kreun V, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010, i ndryshuar.

Për vitet objekt auditimi, në lidhje me hartimin e regjistrit të riskut, në përcaktimin e risqeve sipas objektivave për çdo drejtori, sektorë dhe njësi, në mbështetje të nenit 21 të ligjit 10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar, me shkresat nr. 66/2 prot. dt. 27.2.2018, shkresa nr. 632/1 prot. dt. 28.2.2019 dhe nr. 72/1 dt. 7.2.2020 janë dërgur MIE Regjistrat e Riskut për vitet përkatëse sidhe Plani i Veprimit për minimizimin e risqeve. Janë bërë përpjekje për kufizimin e riskut, nëpërmjet marrjes në kohën e duhur të masave efikase, korrigjuese dhe riparuese.

Pavarësisht rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përsëri nga ana e Institucionit nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitet 2018, 2019 dhe 2020 sipas përcaktimit të nenëve 8, 10 dhe 2712 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit "Për MFK". Edhe në kreun II, pika 2.2.6 të Manualit të ri të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, nënvizohet se:

"GMS luan një rol kyç për integritetin e informacionit financiar të njësive publike, sistemit të kontrollit të hëndshëm, si dhe sjelljes etike, Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësive si dhe përkujdeset për performancën e njësive publike".

Aktivitetet e Kontrollit

Janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve, me synim arritjen e objektivave.

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësi. Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa mbivendosje të detyrave.

Në DPD proceset kryesore të punës janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të miratuar nga MIE. Duke patur parasysh kërkesat e kapitullit III të ligjit 10296 dt.08.07.2010 për MFK i ndryshuar, DPD në filozofinë e punës së saj ka implementuar dy sisteme kontrolli.

A-Kontrollet parandaluese.

Ku mund të përmendim:

-Sistemin e dy nënshkrimeve

-I njëjti punonjës mos të jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozim, miratim, zbatim, kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave.

-Para kryerjes së procedurës së prokurimit publik, merret konfirmimi nga financa.

-Para likuidimit të një fature për blerje malli apo kryerje shërbimi, kontrollohen veprimet dhe dokumentacioni i shpenzimeve.

-Respektimi i sasisë dhe cilësisë në kontrata.

B-Kontrollet zbuluese.

Në DPD, këto kontrolle, kanë synuar uljen e riskut të pasojave të padëshirueshme.

Mund të përmendim:

-Kontrollet periodike të lëvizjes së vlerave monetare (gjendja e arkës, ditari I arkës, kontabiliteti).

-Grup pune për përcaktimin e fondit limit për blerjet e vogla.

-Kontroll periodik mbi fondet e shpenzuara.

-Sistemi me dy firma.

Jane miratuar në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Per Arkivat" si të "Normave tekniko- profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", rregullat për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivor të fondkrijuesit, etj.

Informimi dhe komunikimi

Komunikimi është shkëmbimi i informacionit të dobishëm midis njerëzve në të gjitha nivelet si në mënyrën vertikale dhe horizontale. Informacioni duhet t'ju komunikohet menaxherëve dhe punonjësve të tjerë që kanë nevojë brenda një afati kohor dhe që i ndihmon ata për kryerjen e detyrave të tyre.

Mënyra e komunikimit më e përdorëshme në DPD Durrës është ajo me shkrim (rruga protokollare), sipas së cilës çdo drejtori komunikon me sektorët brenda institucionit si dhe mban korespondencën me institucionet e tjera.

Gjithashtu vend kryesor zë edhe komunikimi verbal.

Në rregullore të brendshme nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit.

Në DPD komunikimi horizontal dhe vertical (informacioni në strukturat eprorë dhe paralele është në efikasitet.

Përveç kësaj informacioni realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuar për publikun.

Grupi i auditimit konstaton se, në shumicën e rasteve, informacioni ligjor apo që shoqëron një praktikë vendimmarrje, është i mjaftueshëm.

Në raste kur lind nevoja për informacion specifik, të detajuar, përgjegjësit e sektorëve hartojnë informacionin shtesë në Memo.

Në DPD informacioni jepet në mënyrë periodike, mujor, 3-mujor, 6-mujor, 9-mujor dhe vjetor.

Të gjithë punonjësit e DPD janë të pajisur me e-mail zyrtar.

Theksojmë se mungon zyra e IT dhe specialist IT. Nuk ka sistem IT, i cili të garantojë hedhjen e të dhënave dhe raportimin e tyre.

Komunikimi zyrtar me institucionet e tjera bëhet në rrugë zyrtare me shkrim dhe firmoset nga titullari i institucionit, sipas kompetencave të përcaktuara në ligj. Korrespondenca e marrë dhe dërguar në rrugë elektronike do të konsiderohet korrespondencë zyrtare dhe do të trajtohet si e tillë.

Njohja dhe shfrytëzimi i dokumenteve të DPD-së bëhet në mbështetje të ligjit për informimin publik si dhe të dispozitave të tjera nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave.

Titullari i DPD në kuadër të tërësisë së proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të aresyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Informohet vazhdimisht nga drejtorët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve apo, raporteve të ndryshme.

Monitorimi

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë.

Për periudhën objekt auditimi, procedurat e ndjekura në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, për monitorim kanë qenë në përputhje me kulturën e njësisë dhe rregullat e brendshme për të garantuar përshtatshmërinë me ligjin.

N/Autorizues në rastin konkret Drejtori i Përgjithshëm i DPD ka monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm në institucion nëpërmjet pyetësorëve për vetvlerësimin e komponentëve të MFK.

Vlerësimi është bërë nëpërmjet mekanizmave individual të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme.

Nga intervistimi i përgjegjësve të sektorëve deklarohet se në vazhdimësi bëhet vlerësimi i sistemit, por nuk dokumentohet ky proces.

Konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike (me përjashtim të analizave vjetore) që institucioni i ka paraqitur në MIE nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut VI, paragrafi 257, nën-pika 63 "Raportet e monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", ku shprehimisht përcaktohet që: Raportet e monitorimit të buxhetit të publikohen në faqen zyrtare të çdo ministrie të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive.

Inventaret e mjeteve lundruese dhe motoreve të tjera detare mbahen në regjistra dhe mungojnë të dhëna dixhitale të tyre (skanimi i këtyre mjeteve), të cilat të jenë në dispozicion të stafit të DPD në mënyrë elektronike.

Për sa të sipër Paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

GRUPI I AUDITIMIT

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

**A.T.
I.B.**

R.Xh.